# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5995
E shtunë, 8 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

## IKShPK-ja: Rreziku për depërtimin eventual të koronavirusit në Kosovë mbetet i ulët FAQE 10




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ FAQE 4-5

# TAKSËN NDAJ SERBISË DO TA MBROJMË ME TË GJITHA MJETET DEMOKRATIKE



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka paralajmëruar se kjo parti do ta kundërshtojë me të gjitha mjetet demokratike heqjen e taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zëvendësimi i kësaj takse me reciprocitet është veprim i pamenduar mirë. Sipas tij, aplikimi i parimit të reciprocitetit do të jetë një lehtësi për Serbinë. Ish-ministri Lekaj ka vlerësuar se aplikimi i reciprocitetit në raport me Serbinë dëmton qytetarët e Luginës së Preshevës



## Shuhet ikona e muzikës shqipe

Ka ndërruar jetë, në moshën 86-vjeçare, ikona e muzikës shqipe, Nexhmije Pagarusha. "Bilbili i Kosovës" me një zë të jashtëzakonshëm për 40 vjet i këndoi dashurisë, dhimbjes dhe vendlindjes në të gjitha zhanret si dhe emocionoi publikun shqiptar në Kosovë dhe Shqipëri. Vdekja e saj është vlerësuar humbje e madhe për kulturën mbarëshqiptare. Me kërkesën e kryeministrit Albin Kurti, ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, do të merret me organizimin e ceremonisë së varrimit të këngëtares Nexhmije Pagarusha. Ende nuk është saktësuar dita e varrimit, por përmendën si ditë të mundshme, e diela ose e hëna e ardhshme FAQE 3

## Kurti: Qeveria do të jetë pranë banorëve të Klinës, Istogut dhe Pejës

FAQE 3



## AKTUALE

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË PODUJEVËS MBAHEN MË 15 MARS F. 4

GRENELLI I THOTË VESELIT SE TAKSA DUHET TË HIQET F. 3

NË KLINIKËN E ORL-së U OPERUAN MBI 2 000 PACIENTË F. 5



## EKONOMI

NISIN PROCEDURAT PËR ANULIMIN E KONTRATËS 110 MILIONËSHE PËR AUTOSTRADËN E GJILANIT F. 8

HEQJA E BARRIERAVE TREGTARE, NË FUNKSION TË DIALOGUT DHE NORMALIZIMIT F. 9



## KULTURË

GJUHA, LETËRSIA DHE KULTURA SHQIPTARE NË DIJEN EVROPIANE F. 14

Fitim VELIU

## SPORT

NË KËRKIM TË GJYSMËFINALES SË KUPËS F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Mazhoranca po hedh në erë gjithë institucionet kushtetuese

TIRANË, 7 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ka folur për përplasjet me mazhorancën e Partisë Socialiste dhe shkeljet ligjore të qeverisë. Duke folur për emërimet në Gjykatën Kushtetuese, ai deklaroi se mazhoranca ka si synim që të kapë edhe këtë institucion, që ende nuk është kapur prej saj. Presidenti u shpreh se mazhoranca do të kapë edhe këtë institucion të fundit që nuk është kapur prej saj, duke hedhur ne erë të gjithë besueshmërinë ndaj institucioneve të reja të drejtësisë. "Unë dua të them se është një nismë e keqe, tregojnë mungesë të respektit për shtetin ligjor dhe për Kushtetutën. Është një kokëfortësi e cila nuk na ndihmon që të rrisim besueshmërinë brenda dhe jashtë vendit se po çojmë më tej reformën në drejtësi, aq më tepër për një çështje kaq të mprehtë sa Gjykata Kushtetuese. Kjo është një përpjekje për të bërë Gjykatën Kushtetuese partiake. Presidenti ka bërë më të mirën që Shqipëria të mos ngelet kurrë pa Gjykatë Kushtetuese dhe të mos cenohet puna në këtë gjykatë. Kushtetuta e ka të shkruar pikë më pikë të saktë si veprohet dhe presidenti ka vepruar drejt me ligjet. Mazhoranca do të kapë edhe këtë institucion të fundit që nuk është kapur prej saj, duke hedhur ne erë të gjithë besueshmërinë ndaj institucioneve të reja të drejtësisë", deklaroi presidenti Meta.



# Miroslav Lajçak, ndërmjetës në dialogun Kosovë - Serbi?

Sipas burimeve diplomatike, ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak, pritet të jetë përfaqësues i posaçëm i BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por në selinë e Bashkimit Evropian nuk kanë dashur të komentojnë derisa të mos ketë ndonjë vendim formal



Prishtinë, 7 shkurt - Edhe pse në selinë e Bashkimit Evropian nuk duan të komentojnë derisa të mos ketë ndonjë vendim formal, sipas burimeve diplomatike, ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak, pritet të jetë përfaqësues i posaçëm i BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Emri i tij është përmendur shpesh në media, por edhe në qarqet diplomatike, mirëpo këto janë quajtur gjithmonë vetëm si spekulime.

Zëdhënësi i BE-së për çështje të Politikës së Jashtme, Petar Stano, ka thënë të premten në një konferencë me gazetarë se ende nuk ka vendim se a do të ketë apo jo të dërguar të posaçëm dhe se BE-ja nuk dëshiron të spekulojë lidhur me emrat e kandidatëve që janë përmendur në media, ka njoftuar rfe.

Sipas burimeve diplomatike ka pasur vetëm disa rezerva ndaj emërimit të Miroslav Lajçakut, pasi edhe ai, sikurse dhe Përfaqësuesi i Lartë, Josep Borrell, vjen nga një vend që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës.

Të njëjtat burime thonë se në ditët në vijim do të duhet të sqarohet edhe statusi, të cilin një përfaqësues i tillë i posaçëm do ta ketë brenda institucioneve të Bashkimit Evropian. Nëse ai do të jetë vetëm i dërguar i posaçëm, atëherë mund të emërohet vetëm nga përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell. Por, nëse do të jetë përfaqësues i posaçëm, atëherë duhet ta marrë edhe pëlqimin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në Këshill.

Lajçak ka një përvojë të madhe nga rajoni i Ballkanit, meqë ka qenë përfaqësues i Posaçëm në Bosnjë e Hercegovinë dhe i dërguar i Posaçëm para referendumit në Mal të Zi. Ai ka përvojë edhe nga shërbimi i Jashtëm i BE-së, ku ka shërbyer në të kaluarën si drejtor menaxhues.

Idenë që të ketë një përfaqësues të posaçëm për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, e ka përmendur gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe Serbi edhe përfaqësuesi i Lartë, Borrell.

Një emërim i tillë, sipas diplomatëve, do t'i jepte rolit të BE-së si lehtësuese e dialogut, një dimension më shumë politik sesa që kishte deri më tash.

Në BE pohojnë se sa i përket Kosovës dhe dialogut të saj me Serbinë nuk bëjnë gara me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, disa diplomatë thonë se emërimi i të dërguarve të posaçëm amerikanë për dialog ka ndikuar që edhe në BE të mendojnë për një gjë të tillë.

Përderisa pritet të sqarohen roli dhe posti formal i përfaqësuesit të ardhshëm për dialogun Kosovë-Serbi, në BE vazhdojnë paralelisht edhe përgatitjet për samitin e Zagrebit dhe për metodologjinë e re në procesin e zgjerimit. Për këto tema, me datën 16 të këtij muaj në Bruksel do të zhvillohet një darkë pune ndërmjet krerëve të institucioneve të BE-së dhe liderëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Nga BE-ja në takim do të marrin pjesë presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula van der Leyen, dhe kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenkoviq, si shef i qeverisë së vendit që ka kryesimin e radhës së BE-së.

## Basha: Këshilli i Evropës konfirmoi se më 30 qershor nuk pati zgjedhje

Tiranë, 7 shkurt - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka përshëndetur të premten deklaratën e zyrtarëve të Këshillit të Evropës në lidhje me votimet e 30 qershorit 2019. Basha deklaron se Këshilli i Evropës ritheksoi se më 30 qershor nuk pati zgjedhje dhe se beteja më jetike sot është për zgjedhje të lira. "Përshëndes deklaratën e Misionit të KiE-së që ritheksoi se më 30 qershor nuk pati zgjedhje, se pushteti vendor sot nuk është pluralist, dhe as i qytetarëve. Beteja më jetike sot është për zgjedhje të lira dhe të ndershme, për t'ua kthyer qytetarëve qeverisjen legjitime qendrore dhe vendore", shkruan kreu i PD-së Lulzim Basha në "Twitter".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kurti: Qeveria do të jetë pranë banorëve të Klinës, Istogut dhe Pejës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

KLINË, ISTOG, PEJË 7 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të premten komunën e Klinës, të Pejës dhe të Istogut, për ta parë nga afër situatën pas erërave të fuqishme që i preken këto anë dhe për t'i dëgjuar kërkesat dhe shqetësimet e banorëve të këtyre komunave, njëkohësisht duke iu premtuar atyre mbështetjen e qeverisë për sanimin e këtyre dëmeve.



Kryeministri Kurti e ka vizituar fshatin Stup të Komunës së Klinës, i shoqëruar nga Hykmete Bajrami, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Besian Mustafa, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj. “Nga kryetari i komunës u njoftuam se kanë krijuar një komision për evidentimin e dëmtimeve dhe porsa të dalim me një regjistër të këtyre dëmeve, si Qeveri e Republikës së Kosovës do të shqyrtojmë se çka mund të ndihmojmë, duke pasur parasysh nevojat më urgjente, së pari”, ka thënë Kurti.

Më tej, kryeministri Kurti ka pohuar se dëmtimet më të mëdha janë në pullazet e shtëpive dhe në serat e fermerëve, duke theksuar se është fat që nga gjithë këto tjegulla të rëna në tokë nuk ka pasur vdekje të njerëzve apo lëndime të tyre. “Dëmet materiale natyrisht që janë e keqja më e vogël kur mund të kesh parasysh se çfarë dëmesh të tjera më të mëdha në njerëz kanë qenë të mundura nga erërat e fuqishme”, është shprehur kryeministri Kurti, duke premtuar se qeveria do të jetë pranë komunës dhe banorëve të Klinës.

Më pas, kryeministri Kurti vizitën e ka vazhduar në Komunën e Istogut, në ndërmarrjen prodhuese “Agroprodukti”, për të parë, siç ka thënë ai, sukseset e kësaj ndërmarrjeje prodhuese dhe të dobishme për ekonominë tonë për punësimin dhe veprimtarinë bujqësore. “Po vijmë në një ditë si kjo pas dëmtimeve të mëdha që keni pësuar nga erërat e fuqishme këtu në Istog”, u shpreh kryeministri Kurti.



Ndër të tjera, kryeministri Kurti falënderoi kryetarin e Komunës së Istogut, Haki Rugova, për praninë dhe tha se është aty bashkë edhe me dy ministrat, në mënyrë që të njoftohen për së afërmi me dëmet e që, pas regjistrimit, evidentimit të vlerësimit të tyre, të shohin edhe si komunë, edhe si qeveri, se çka do të mund të ndihmojnë, duke u përqendruar te nevojat urgjente së pari në një plan më afatgjatë. “Fondi i Sigurimeve Bujqësore i zgjidh këto probleme sepse ne, fatkeqësi pas fatkeqësie, nuk po nxjerrim mësim asnjëherë. Në vende të zhvilluara demokratike perëndimore, në veçanti Bashkimin Evropian, pikërisht me sigurime bujqësore evitohen gjithmonë humbjet prej dëmtimeve të këtilla natyrore, prandaj do të na duhet të merremi sa të mundemi me sanimin e kësaj gjendjeje tash, por në një aspekt më afatgjatë”, ka deklaruar Kurti, i cili ka bërë me dije se vetëm Fondi i Sigurimeve Bujqësore është ai që e zgjidh këtë problem në mënyrë të përhershme që natyrisht se mund të përsëritet për shkak të gjeografisë së kësaj komune e cila është e njohur për erëra të fuqishme.



Po ashtu, kryeministri Kurti ka thënë se dëmtimet që i panë këtu, por edhe në Klinë, të rrjetit elektrik, KEDS-i do të duhej të merrej dhe t'i rregullonte ato, kurse komuna e Istogut, e Klinës dhe e Pejës duhet të shohin se çka mund të bëjnë për t'u dalë në ndihmë familjeve të cilët kanë pësuar dëmtime, posaçërisht në pullazet e shtëpive të tyre. Pas vizitës në Klinë dhe, Istog, kryeministri Kurti ka vazhduar vizitën në Komunën e Pejës, ku ka vizituar edhe shkollën e Mesme të Lartë Ekonomike “Ali Hadri”, për ta parë gjendjen e saj pas erërave të forta në këto anë.

# Grenell i thotë Veselit se taksa duhet të hiqet

Prishtinë, 7 shkurt (ER) - I dërguari i presidentit amerikan për dialogun Kosovë-Serbi, ambasadori Richard Grenell përmes një postimi në llogarinë e vet në “Twitter”, i ka thënë kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, se taksa ndaj mallrave serbe duhet të hiqet dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka të drejtë në këtë drejtim. “Kadri, Shtetet e Bashkuara po kërkojnë që Kosova ta heqë tarifën 100 për qind. Ajo e dëmton Kosovën dhe pengon bizneset për krijimin e vendeve të punës. Albini ka të drejtë për këtë”, ka shkruar Grenell.



Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka kundërshtuar të enjten paralajmërimin e Kurtit për heqjen e taksës. Në profilin e tij në “Facebook”, ka shkruar se ndihet i shqetësuar për ngutin e tepruar të kryeministrit të ri për t'i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe. “Taksa ndaj importeve serbe ka qenë vendim dinjitoz i shtetit tonë për t'iu kundërvënë sulmeve të njëpasnjëshme që Serbia ka bërë kundër Kosovës. Shpreh shqetësimin për ngutin e tepruar të kryeministrit të ri për t'i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe, e cila u largua nga qeveria e kaluar për shkak të taksës”, ka shkruar Veseli.

Sipas tij, qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën. “Një qeveri ka rënë si pasojë e taksës, gjë që ka dobësuar për një kohë Kosovën. Prandaj, nuk duhet të ketë manovrime politike për këtë temë të ndjeshme, e cila rrezikon ta dëmtojë më tej vendin tonë. Qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë, përpara sfidave dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën”, ka shkruar Veseli.

Partia e Veselit ka qenë pjesë e koalicionit qeveritar kur ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë vendim për taksën në nëntor të vitit 2018.

Thirrje për heqje të taksës patën bërë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, mirëpo Haradinaj nuk ishte zmbrapsur. Të enjten edhe vetë Haradinaj i ka kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që të mos heqë dorë nga kjo masë. Por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind të vendosur nga qeveria e kaluar për importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina me reciprocitetin e plotë politik, ekonomik dhe tregtar.



FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

# Taksën ndaj Serbisë do ta mbrojmë me të gjitha mjetet demokratike

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka paralajmëruar se kjo parti do ta kundërshtojë me të gjitha mjetet demokratike heqjen e taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zëvendësimi i kësaj takse me reciprocitet është veprim i pamenduar mirë. Sipas tij, aplikimi i parimit të reciprocitetit do të jetë një lehtësi për Serbinë. Ish-ministri Lekaj ka vlerësuar se aplikimi i reciprocitetit në raport me Serbinë dëmton qytetarët e Luginës së Preshevës

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka kundërshtuar paralajmërimin e Qeverisë së re për zëvendësimin e taksës 100 ndaj mallrave serbe me reciprocitet. Ai ka bërë me dije se AAK-ja do të kundërshtojë këtë gjë me të gjitha mjetet demokratike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se heqja e taksës është veprim i pamenduar mirë. "Ne do t'i përdorim të gjitha metodat demokratike për ta kundërshtuar heqjen e taksës. Nuk mendoj se z. Kurti nuk e ka llogaritur këtë, sepse ne si opozitë, si Aleancë, do të bëjmë veprime që të mos lejojmë në asnjë mënyrë që të hiqet taksa prej 100 përqindësh ndaj mallrave serbe", ka thënë Lekaj.

Ai ka thënë se aplikimi i reciprocitetit në raport me Serbinë nuk do t'i ketë efektet e taksës. "Nëse e marrim reciprocitetin në aspektin ekonomik, me çka mundet Kosova t'i konkurrojë tregut të Serbisë, kur dihet që eksporti i Kosovës me Serbinë është pothuajse zero. Ndërsa Serbia bën eksport në Kosovë deri në 500 milionë euro në vit. Atëherë, kush ka llogari këtu dhe në dobi të kujt shkon heqja e taksës, pa u ulur në tavolinë dy shtetet dhe pa e njohur Serbia Kosovën si shtet", ka deklaruar Lekaj, duke shtuar se aplikimi i reciprocitetit në dokumentet e udhëtimit, në pasaporta, do t'i dëmtojë qytetarët e Luginës së Preshevës.

Lekaj, i cili ka qenë ministër i Infrastrukturës në mandatin e kaluar, ka folur edhe për paralajmërimet e qeverisë së re për ta anuluar autostradën e Dukagjinit dhe atë të Gjilanit. Sipas tij, këto veprime janë atak ndaj interesave të qytetarëve të këtyre anëve. "Mirëpo marrja e vendimeve të tilla në ditët e para mendoj se është një mesazh i keq për qytetarët. Paralajmërimi për moszhvillimin e procedurave për Autostradën e Dukagjinit dhe inicimi i procedurave ligjore për anulimin e tenderit në lidhje me autostradën e Gjilanit është një atak në qytetarët e këtyre anëve", është shprehur Lekaj.



**“Epoka e re”:** *Z. Lekaj, kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe me masën e reciprocitetit?*
**Lekaj:** Paralajmërimi i z. Kurti për zëvendësimin e taksës me reciprocitet mendoj se është i pavend dhe i pallogaritur mirë. Kjo është një lehtësi për Serbinë dhe asgjë tjetër. Tani nëse mund të them, i sheh dy Albin Kurta, Albin Kurtin që ka qenë i veshur kuq e zi dhe atë që është i zhveshur. Pra, që e ka zhveshur etja për pushtet. Qeveria e re do të duhej të punojë që ta forcojë shtetin dhe jo ta dobësojë atë. Kjo mendoj se nuk i bën nder z. Kurti dhe qeverisë që është formuar tani.

**“Epoka e re”:** *Pse jeni kundër reciprociteti të plotë me Serbinë?*
**Lekaj:** Nëse e marrim reciprocitetin në aspektin ekonomik, me çka mundet Kosova t’i konkurrojë tregut të Serbisë, kur dihet që eksporti i Kosovës me Serbinë është pothuajse zero. Ndërsa Serbia bën eksport në Kosovë deri në 500 milionë euro në vit. Atëherë, kush ka llogari këtu dhe në dobi të kujt shkon heqja e taksës, pa u ulur në tavolinë dy shtetet dhe pa e njohur Serbia Kosovën si shtet. Pastaj, nëse e marrin reciprocitetin politik, ju po e shihni se në të gjitha takimet që është Serbia po lufton kundër Kosovës. Pra, Serbia nuk do ta njohë realitetin e ri të krijuar në Kosovë dhe po vazhdon ta kundërshtojë atë. Po ashtu, nëse ne aplikojmë reciprocitetin në dokumentet e udhëtimit, në pasaporta, do t’i dëmtojmë qytetarët e Luginës së Preshevës, sepse dihet se sa qytetarë shqiptarë të kësaj ane vijnë në Kosovë. Me këto veprime mendoj se po shkojmë drejt të panjohurave dhe po u shkaktojmë dëme shumë të mëdha bizneseve dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve. Në këtë drejtim mendoj se heqja e taksës është diçka e pallogaritur mirë, e paanalizuar, dhe nuk na çon askund tjetër, vetëm në favore për Serbinë.

**“Epoka e re”:** *Mirëpo përfaqësuesi special i presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, z. Grenell, përsëri ka kërkuar heqjen e taksës. Si do të veprojë Kosova në këtë drejtim?*
**Lekaj:** Raportet e Kosovës me ShBA-në janë të shkëlqyeshme, sepse shtetin e Kosovës e kemi krijuar bashkë me ShBA-në. Në këtë drejtim mikut të mirë duhet t’i ndihmojmë, por jo që kjo të ndodhë pa ndonjë kompromis të Serbisë. Pra, pa njohje të Kosovës ne nuk duhet t’ia japim tregun Serbisë. Këtë ish-kryeministri i Kosovës, z. Haradinaj, e ka bërë të qartë se ne jemi bashkëpunëtorë të mirë me miqtë tanë amerikanë, mirëpo te ne duhet të dominojë interesi i qytetarëve tanë. Nëse ne e bëjmë këtë kompromis, pra heqjen e taksës, pa fituar asgjë, është një gabim që na çon në procese të panjohura.

**“Epoka e re”:** *Nëse qeveria e re e bën një veprim të tillë, cili do të jetë reagimi i AAK-së? Si do ta kundërshtoni heqjen e taksës?*
**Lekaj:** Ne do t’i përdorim të gjitha metodat demokratike për ta kundërshtuar heqjen e taksës. Nuk mendoj se z. Kurti nuk e ka llogaritur këtë, sepse ne si opozitë, si Aleancë, do të bëjmë veprime që të mos lejomë në asnjë mënyrë që të hiqet taksa prej 100 përqindësh ndaj mallrave serbe.

**“Epoka e re”:** *Gjithashtu, ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, ka njoftuar se ka iniciuar procedurat ligjore për anulimin e tenderit në lidhje me autostradën e Gjilanit, projekt ky i filluar nga ju. Cili është komenti juaj?*
**Lekaj:** Po e shihni pra sesi ‘yrysh qeveria’ po ngutet për t’i ndalë projektet që janë në të mirë të qytetarëve. Pra, po ngutet për ta hequr taksën, për ta penguar këtë projekt të madh për qytetarët e Anamoravës. Ky është një presion që po u bëhet zyrtarëve të prokurimit publik. Këta ose nuk e njohin sistemin, ose këto veprime po i bëjnë në mënyrë të qëllimshme dhe po e nxisin reagimin e qytetarëve.

**“Epoka e re”:** *Për çfarë reagimi po mendoni, z. Lekaj?*
**Lekaj:** Mendoj se qytetarët e Anamoravës kanë plotësisht të drejtë ta kundërshtojnë një gjë të tillë sepse ne si Ministri e Infrastrukturës kemi ndjekur anën ligjore, duke u mbështetur në Ligjin e Prokurimit Publik dhe ministri nuk është ai që ndërhyn në prokurimin publik. Pra, nenet e atij ligji tregojnë se ministri nuk ka të drejtë të bëjë presion mbi zyrtarët apo të ndërhyjë dhe të ndalojë diçka që është ligjore. Kjo le të mbetet në natyrën e tyre. Unë si ish-ministër do ta sqaroj këtë çështje në detaje gjatë ditëve të ardhshme.

**“Epoka e re”:** *Këto paralajmërime dhe veprime të para të qeverisë së re, çfarë mesazhe dërgojnë?*
**Lekaj:** Paralajmërimet dhe veprimet e tyre nuk janë mesazhe të mira për qytetarët. Unë me marrjen e postit të ministrit nuk kam anuluar asnjë tender, edhe pse kam pasur të drejtë të kërkojë sugjerime dhe këshilla. Por, kam vazhduar rrugën institucionale për të ecur punët. Nuk ndryshon bota me ardhjen e kësaj qeverie në pushtet. Nuk ka ndryshuar bota as kur ne i kemi marrë përgjegjësitë qeverisëse. Jeta vazhdon. Mirëpo marrja e vendimeve të tilla në ditët e para, mendoj se është një mesazh i keq për qytetarët. Paralajmërimi për moszhvillimin e procedurave për Autostradën e Dukagjinit dhe inicimi i procedurave ligjore për anulimin e tenderit në lidhje me autostradën e Gjilanit, është një atak për qytetarët e këtyre anëve.

# Zgjedhjet për kryetar të Podujevës mbahen më 15 mars

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHKURT - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, e ka shpallur datën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës. Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës, bazuar në vendimin e presidentit Thaçi, do të mbahen më 15 mars 2020.
Agim Veliu nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka hequr dorë nga kjo pozitë, pasi është emëruar ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë e re të Kosovës.
Presidenti Thaçi e ka udhëzuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Podujevës në përputhje me vendimin e tij dhe ligjin në fuqi.
Po ashtu, në vendimin e presidentit Thaçi thuhet se në pajtim me nenin 10 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (GZ, Nr. 10, 03 prill 2019), Kuvendi i Komunës dhe ekzekutivi i Komunës së Podujevës nuk mund të marrë asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës.



# Në Klinikën e ORL-së u operuan mbi 2 000 pacientë



PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Në Klinikën e Otorinolaringologjisë (ORL) të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës mjekët, në bashkëpunim me stafin tjetër shëndetësor, kanë realizuar 2 215 operacione gjatë vitit 2019.
Në sajë të raportit të punës për 12-mujorin e vitit të kaluar, kishte 962 raste në ambulanca të pranimit. Të dhënat zyrtare, po ashtu, tregojnë se në Klinikën e ORL-së janë shtrirë 2 359 pacientë. Gjatë kësaj kohe kishte 10 402 vizita specialistike dhe 5 929 vizita subspecialistike. Në periudhën janar-dhjetor 2019 janë ofruar 379 shërbime logopedike, 3 902 shërbime të audiometrisë tonale matje të dëgjimit), 1 353 timpanometri (ekzaminimi i lëvizshmërisë i membranës timpatnike dhe kockave të dëgjimit) dhe 1 760 shërbime për pastrim të veshëve.

# Kurti pret në takim shoqërinë e ngushtë të Lëvizjes Studentore të '97-s dhe disa profesorë të vet



PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim shoqërinë e profesorët e vet të kohës së studimeve. "Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi, Ahmet Geca, Hajrullah Koliqi, Milot Cakaj, Mihane Salihu, Jeton Rexha, Naim Havolli, Ernest Luma e Fatban Bunjaku më uruan e nderuan me vizitën që ma bënë. Me ta kemi kaluar shumë sfida. Prej vështirësisë së literaturës për studime e provime, deri tek organizimi i protestës së 1 Tetorit 1997 dhe të tjerave më pas", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurti ka thënë se kanë ndarë shumë gjëra bashkë, kurse sot kanë një dëshirë të përbashkët: zhvillimin dhe forcimin e vendit tonë. "Janë 342 profesorë e studentë të cilët janë dëshmorë e martirë të luftës së fundit çlirimtare. Profesori Hajrullah Koliqi propozoi një lapidar i cili do t'i nderonte ata. Si kryeministër i Republikës së Kosovës do t'i marr hapat e nevojshëm që kjo kërkesë të jetësohet në këtë vit", ka shkruar ai.

Kryeministri Kurti ka thënë se në këtë muaj, më 15 shkurt, Universiteti i Prishtinës (UP) shënon 50-vjetorin e themelimit. Sipas tij, aktivitetet e UP-së janë paraparë nga 10 shkurti deri më 15 shkurt. "Brenda këtyre pesë ditëve, çdo ditë do të jetë e mbushur me aktivitete që të nderohet ky institucion i cili i dha shumë vendit, por që potenciali i tij është edhe më i madh se tani. E ky institucion nuk do të ishte i tillë pa pjesëmarrjen e rektorit, prof. Ejup Statovcit. Në këtë vit, më 16 prill, prof. Statovcit do t'i shënohet 80-vjetori i lindjes e ne si institucion e kemi për obligim që ta nderojmë ashtu siç ai e meriton. Kur tek ne shihet diçka e mirë nuk është meritë e jona sa është meritë e prof. Statovcit. Urtësia e mësimet e tij të shumta na udhëzojnë ende në vështirësitë tona që nuk janë të pakta. Dija e mësimi edukativ do të jenë prioritet i qeverisë sonë. Leximi e shkenca në njërën anë duhet të thellohen, por edhe të kompletohen me kulturën e artin në anën tjetër", ka shkruar kryeministri Kurti.

# Promovohet libri 'Siguria kolektive dhe dilemat rreth intervenimit humanitar ndërkombëtare'



GJILAN, 7 SHKURT (ER) - Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan është promovuar të premten monografia e titulluar "Siguria kolektive dhe dilemat rreth intervenimit humanitar ndërkombëtare", mësime të nxjerra nga rasti i Kosovës e autorit prof. dr. Dukagjin Leka, njëherësh prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ. Kjo monografi paraqet një analizë të detajuar të sistemit të sigurisë ndërkombëtare të trasuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Prof. sr. Abdulla Azizi dhe prof. asoc. dr. Sabiha Shala, pasi kanë uruar autorin për punën e bërë, kanë paraqitur recensionet e tyre për librin monografik "Siguria kolektive dhe dilemat rreth intervenimit humanitar ndërkombëtar". Prof. dr. Abdulla Azizi ka thënë se kjo monografi paraqet një kontribut të ri akademik për audiencën kosovare. Sipas tij, autori bën një analizë të thelluar të instrumenteve në dispozicion të së drejtës ndërkombëtare. Sipas Azizit, teksti monografik i autorit Leka bëhet i rëndësishëm si në kuadrin e një vlere të shtuar për studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe sigurisë ndërkombëtare në mjedisin akademik shqiptar. Ai ka pohuar se autori me një seriozitet shkencor trajton rolin sistemit ndërkombëtar në sigurinë ndërkombëtare tek rajone të ndryshme të krizës, ndërsa veçanërisht e trajton rastin e Kosovës dhe dilemat e intervenimit ndërkombëtar humanitar.

Recensenti Azizi thotë se, duke u bazuar në argumentet e lartpërmendura, fuqishëm e përkrah botimin e monografisë së prof. ass. dr. Dukagjin Leka, duke thënë se kontributi i tij nga profili i një intelektuali është shumë domethënës për popullin shqiptar në Kosovë dhe më gjerë, ndërsa ky tekst do t'u shërbejë jo vetëm studentëve dhe profesorëve, por edhe të gjithë të interesuarve të tjerë si studiues të cilët do të merren me këtë problematikë, zyrtarë në institucionet qeveritare apo joqeveritare si dhe lexuesit në përgjithësi.

Prof. asoc. dr. Sabiha Shala, duke paraqitur recensionin e saj për librin monografik "Siguria kolektive dhe dilemat rreth intervenimit humanitar ndërkombëtar", ka thënë se autori shtjellon elemente të veçanta të bazuara në raste, mbi sigurinë kolektive dhe intervenimin humanitar. "Libri monografik i autorit prof. ass. dr. Dukagjin Leka ruan një marrëdhënie sublime me librat e autorëve të huaj sa i përket çështjes së sigurisë kolektive dhe intervenimit humanitar. Sidoqoftë, autori Leka bën interpretim unik historik dhe ndërlidh në mënyrë të përshtatshme veprimet praktike duke nxjerrë përfundime që mbështesin idenë e intervenimit humanitar", ka thënë Shala në recensionin e saj.

Ndërsa në fjalën e tij, rektori i Universitetit "Kadri Zeka", prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, pasi ka uruar prof. ass. dr. Dukagjin Leka për librin, ka thënë se ai vë në pah njohuritë e tij shkencore dhe përvojën akademike, duke u kualifikuar si njohës i mirë i disiplinës së trajtuar dhe suksesshëm arrin qëllimin e librit. Derisa vetë autori, prof. ass. dr. Dukagjin Leka, ka falënderuar të gjithë ata që kanë ndihmuar në realizimin e botimit të librit të tij monografik "Siguria kolektive dhe dilemat rreth intervenimit humanitar ndërkombëtar".

## Ministrja Bajrami takon rektorin dhe Këshillin Drejtues të UP-së

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka vizituar të premten Rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ku është takuar me rektorin Marjan Dema dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të këtij universiteti.

Ministrja Bajrami e ka përgëzuar menaxhmentin e universitetit për rezultatet e arritura në këtë institucion të arsimit të lartë publik, ndërsa ka shpalosur vizionin e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e arsimit në Kosovë, në veçanti të arsimit të lartë.

Ministrja e Arsimit ka theksuar se do të punohet me të gjithë aktorët dhe të gjithë ata që mund ta japin kontributin e tyre për ta përmirësuar dhe zhvilluar arsimin e lartë, nivel ky që më pas do të kontribuojë në përmirësimin e sektorëve të tjerë. Nga ana e tij, rektori Demaj ka falënderuar ministren Bajrami dhe, po ashtu, ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në mënyrë që Universiteti i Prishtinës, por edhe arsimi i lartë në përgjithësi, të arrijnë suksese të reja.



# Shuhet ikona e muzikës shqipe



**Ka ndërruar jetë, në moshën 86-vjeçare, ikona e muzikës shqipe, Nexhmije Pagarusha. "Bilbili i Kosovës" me një zë të jashtëzakonshëm për 40 vjet i këndoi dashurisë, dhimbjes dhe vendlindjes në të gjitha zhanret, si dhe emocionoi publikun shqiptar në Kosovë dhe Shqipëri. Vdekja e saj është vlerësuar humbje e madhe për kulturën mbarëshqiptare. Me kërkesën e kryeministrit Albin Kurti, ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi do të merret me organizimin e ceremonisë së varrimit së këngëtares Nexhmije Pagarusha. Ende nuk është saktësuar dita e varrimit, por përmenden si ditë të mundshme, e diela ose e hëna e ardhshme**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në moshën 86-vjeçare ka ndërruar jetë këngëtarja e njohur nga Kosova, Nexhmije Pagarusha. Lajmin e ka bërë me dije vajza e saj, Cuca Pagarusha, e cila ka publikuar një fotografi zie në profilin e vet në "Facebook".

Vdekja e artistes së madhe, e cila njihej si "Bilbili i Kosovës", është pritur me pikëllim të madh nga liderët shtetërorë të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe nga komuniteti i artistëve.

Nexhmije Pagarusha e ka lënë amanet të varroset në fshatin e vet, Pagarushë. Kjo është bërë me dije nga Sadik Kryeziu, familjar i këngëtares. Por, ende nuk është saktësuar dita e varrimit, megjithatë përmenden si ditë të mundshme, e diela ose e hëna e ardhshme.

Ikona e muzikës shqiptare me një zë të jashtëzakonshëm i këndoi dashurisë, dhimbjes dhe vendlindjes në të gjitha zhanret, si dhe emocionoi për 40 vjet në skenë shqiptarët në Kosovë dhe Shqipëri. Ikja e këngëtares nga kjo botë është vlerësuar humbje e madhe për kulturën mbarëshqiptare.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Nexhmije Pagarusha përjetësoi muzikën shqipe. "Të pikëlluar me vdekjen e artistes së madhe, Nexhmije Pagarushës, e cila me zërin e saj e përjetësoi muzikën shqipe, duke i dhënë vlera të përjetshme, me të cilat krenohet krejt bota shqiptare. Ndarja nga jeta e Nexhmije Pagarushës është një humbje e madhe për kulturën dhe artin tonë kombëtar. Zëri i saj karakteristik e shndërroi në një ikonë të papërsëritshme, bazuar në dhuntitë dhe talentin e saj të pakufishëm. I përjetshëm do të mbetet emri dhe zëri i Bilbilit të Kosovës", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Vdekjen e Nexhmije Pagarushës si humbje të pazëvendësueshme e ka vlerësuar edhe presidenti shqiptar, Ilir Meta. "E dashur dhe e admiruar nga të gjitha brezat për vokalin e jashtëzakonshëm, emocionet dhe krenarinë që i dhuroi kombit në dekada, kjo humbje e pazëvendësueshme i ka prekur sot të gjithë shqiptarët dhe admiruesit e saj kudo", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dërguar këtë telegram ngushëllimi familjes Pagarusha. "Sot me dhimbje të madhe mësova se është ndarë nga jeta ikona e muzikës shqipe, znj. Nexhmije Pagarusha. Për dhjetëvjetësha të tërë, me zërin e saj kumbues, ajo e kultivoi muzikën e mirëfilltë shqipe, duke u shndërruar në mbretëreshën e saj. Nga 'Baresha' te 'Zambaku i Prizrenit', këngët e saj do të mbeten pjesë e trashëgimisë sonë kulturore dhe vlerë e patjetërsueshme e identitetit tonë", ka thënë Osmani në telegramin e saj.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka ngushëlluar artdashësit me rastin e vdekjes së bilbilit të Kosovës, Nexhmije Pagarusha. "Sot për ty të gjithë i kemi sytë e njomë! Bilbili na la. Këngët e saj po më sillen nëpër kokë. Zëri i saj s'pushon. Mes pak minutave të lirë nga takimi në takim, që po i kam, po e gjej veten duke menduar rreth këtyre këngëve. Nexhmije Pagarusha, talentja e papërsëritshme muzikore, vdiq sot në moshën 86 vjeçare. La pas vetes plot pesë albume e 88 këngë. Më shumë vepra se vite jetë. Secila këngë më e mirë se tjetra. Ngushëllime të gjithë artdashësve. Kjo është humbje e madhe për gjithë popullin e për muzikën", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se vdekja e Nexhmije Pagarushës ka lënë boshllëk të madh në themelet e botës sonë të artit. "Kombi shqiptar humbi sot një nga figurat më të ndritura të muzikës që rrallëherë lindin, por që kujtohen përjetë. Ndarja nga jeta e Nexhmije Pagarushës ka lënë një boshllëk të madh në themelet e botës sonë të artit", ka shkruar Veseli.

Ngushëllime familjes dhe miqve të Pagarushës u ka shprehur edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. "Nexhmije Pagarusha për dekada të tëra kultivoi këngë të mirëfillta shqiptare, të cilat dëgjoheshin me endje në çdo familje", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.

Edhe ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, i ka dërguar familjes Pagarusha një telegram ngushëllimi. "Nexhmija ka lënë pas vetes një trashëgimi të pasur, ndaj së cilës jemi falënderues dhe përballë së cilës kemi përgjegjësi. Shumë këngë të saj janë shndërruar në himn jete për familjet e Kosovës. Ajo me punën dhe kontributin e saj ka sjellë një epokë identitare në fushën e këngës dhe të muzikës shqipe, duke përfituar respektin e të gjithëve që e kanë njohur, sidomos atyre të botës muzikore, por edhe më gjerë. Këngët e saj, veçmas 'Baresha', janë kryevepra të artit muzikor. Ne jemi brez me fat që u rritëm me këngët e saj", ka vlerësuar Dumoshi në telegramin e ngushëllimit.

Me kërkesën e kryeministrit Albin Kurti, ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, do të merret me organizimin e ceremonisë së varrimit të këngëtares Nexhmije Pagarusha.

Pagarusha kishte lindur në maj të vitit 1933, kurse karrierën muzikore e kishte filluar në vitin 1948 në Radio Prishtinë. Pagarusha ishte nderuar nga Presidenca e Kosovës me çmimin "Artiste e Merituar", ndërkaq Presidenca Shqiptare e kishte nderuar me titullin "Nderi i Kombit".

Kënga "Baresha" konsiderohet një nga kryeveprat e interpretimeve të Pagarushës, e cila është realizuar në vitin 1966 nga kompozitori Rexho Mulliqi, me tekst të Rifat Kukajt. Ajo kishte përmbyllur karrierën si këngëtare aktive në vitin 1984 në një koncert në Sarajevë. Por, në vitin 2000, pas 16 vjetësh mungesë në skenë, ajo u rikthye duke kënduar për mediet shqiptare këngën "Për ty". Përveç muzikës, Pagarusha ishte edhe aktore e suksesshme si në film, po ashtu edhe në teatër. Ajo la pas vetes plot pesë albume dhe 88 këngë.

## Amaneti i Nexhmije Pagarushës

Ikona e muzikës shqiptare kishte lënë një amanet sa ishte gjallë. Në janar të vitit 2003 ajo, në një letër, kishte shkruar: "Kur të vdes atë natë të ma lëshoni te varri CD-në 'Lugina e Dashurisë' të këngëtarit Ilir Shaqiri", të cilën letër e kishte nënshkruar.

## Kryeprokurori Isufaj kërkon themelimin e departamenteve shtesë në PSRK

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka dorëzuar të premten në Këshillin Prokurorial dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kërkesën për themelimin e departamenteve shtesë në Prokurorinë Speciale.

Kërkesa është bazuar në Strategjinë për Riorganizimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila strategji është përgatitur me iniciativë të kryeprokurorit Isufaj, pas marrjes së pozitës së kryeprokurorit të PSRK-së.

Sipas strategjisë së lartcekur PSRK-ja, përveç Departamentit për Krime Lufte që është tani, duhet t'i ketë edhe tri departamente: 1. Departamenti për Krim të Organizuar dhe krime të tjera në kompetencë të PSRK-së, 2. Departamenti për Terrorizëm, dhe 3. Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.

Është bërë me dije se qëllimi i themelimit të këtyre departamenteve në kuadër të kësaj prokurorie do ta mundësojë ngritjen e efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe kualitetit të punës së PSRK-së.

Strategjia e PSRK-së mbështetet në disa parime të cilat do të ndikojnë në rolin proaktiv në hetime, llogaridhënie, kontroll dhe mbikëqyrje permanente të punës së prokurorëve dhe në orientim të rezultateve të kësaj prokurorie.

Po ashtu, strategjia ka edhe parimin për promovimin e punës në ekipe të prokurorëve në rastet e rënda, ngritjen e profesionalizmit dhe profilizimin e prokurorëve, bashkëpunimin, krijimin e kushteve adekuate për punë, si dhe komunikimin me publikun.



Për zbatimin e parimeve të lartcekura, PSRK do të funksionojë me një strukturë organizative të ndryshme nga ajo aktuale, do të punojë bazuar në objektiva strategjike të arritshme, si dhe do të ketë një riorganizim të resurseve humane në mbështetje të zbatimit të mandatit të vet.

# Nisin procedurat për anulimin e kontratës 110 milionëshe për autostradën e Gjilanit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të premten ka kërkuar nga të gjitha departamentet përgjegjëse të ministrisë mundësinë e anulimit të tenderit 110 milionë euro për 24 kilometrat Banullë - Dheu i Bardhë. Në konferencë për medie ministri Abdixhiku ka treguar se ka pranuar dy opinione zyrtare nga dy institucione relevante, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe nga Ministria e Financave e Qeverisë së kaluar, të cilat theksojnë qartë se pa alokim paraprak të mjeteve nuk mund të shpallen thirrje që krijojnë obligime financiare për Republikën e Kosovës.
Më tutje, ministri Abdixhiku ka shtuar se është e padëgjuar që një qeveri në ikje, pa buxhet të aprovuar, ta fusë në obligime financiare qeverinë e ardhshme, që do të mund t'i kushtonin vendit me penalizime financiare që kanë ndodhur më parë.
Ministri Abdixhiku ka siguruar qytetarët se projekti në fjalë do të jetë prioritet i qeverisë së re. Duke qenë pjesë e programit qeverisës, thirrja për tenderim mund të ndodhë vetëm pasi të jetë miratuar buxheti i vitit 2020 dhe vetëm pasi t'i kuptojmë saktë mjetet financiare të alokuara për këtë qëllim.
Krahas kësaj, ministri Abdixhiku ka rikujtuar se qeveria e tanishme do t'i shqyrtojë të gjitha vendimet e marra nga qeveria e kaluar që nuk kanë bazë ligjore, me vëmendje të veçantë tek ato vendime me implikime financiare si këto.
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka përshëndetur vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit për anulim të tenderit për autostradën e Gjilanit, për të cilën nuk ishin kalkuluar mirë kapacitetet financiare. "Tri javë më parë Ministria e Infrastrukturës kishte shpallur tenderin për pjesën e dytë të Autostradës së Gjilanit, ndërkohë që realizimi i punëve në pjesën e parë të kësaj autostrade, sipas të dhënave të siguruara nga MI, nuk ka mbërritur as në 40 për qind ndonëse, sipas planifikimeve, kanë mbetur vetëm edhe gjashtë muaj. Kostoja buxhetore të cilën Ministria e Infrastrukturës kishte parashikuar për pjesën e dytë të autostradës është 110.6 milionë euro, ndërkohë që KDI, duke iu referuar Buxhetit të Kosovës



2017-2019, ka gjetur se për pjesën e parë të autostradës ende nuk janë siguruar 60 për qind (ose rreth 53 milionë euro) të mjeteve të nevojshme. Vlera totale për pjesën e parë të autostradës është 94 milionë euro (88.6 milionë kontratat bazë + 5.3 milionë anekskontrata)", është thënë në njoftimin e KDI-së.
Sipas KDI-së, sipas Ligjit për Buxhetin për vitet 2017, 2018 dhe 2019, lidhur me pjesën e parë të autostradës së Gjilanit, deri në vitin 2019 janë ndarë mbi 40 milionë euro. "Sipas vlerave të paraqitura në tabelë, Ministria e Infrastrukturës për pjesën e dytë ka kalkuluar gabimisht vlerën e parashikuar të projektit, 110,641,160.00 euro. KDI-ja ka gjetur se vendimi i qeverisë së kaluar për shpallje të tenderit ishte bazuar në një dokument me përmbajtje jo të saktë, i cili, përveç gabimeve aritmetikore, ishte thirrur në fonde tashmë të shfrytëzuara (ato të vitit 2019). Kujtojmë se për ta përfunduar pjesën e parë të autostradës, e cila është e paraparë të përfundojë këtë vit, Ministria e Infrastrukturës duhet të paguajë edhe 53 milionë euro në vitin 2020. Prandaj, KDI-ja përshëndet vendimin e ministrit Abdixhiku për anulimin e tenderit për pjesën e dytë të kësaj autostrade, veprim i cili ndalon futjen e shtetit në detyrime buxhetore pa kalkuluar kapacitetet financiare", është thënë në njoftimin e KDI-së.

# Dëmtohet tubi i ujit, disa lagje në Prishtinë pa ujë të pijshëm



PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Kompania rajonale e ujësjellësit "KRU" Prishtina ka njoftuar se gjatë ditës së premte në rrugën "Hani i Dilit" në Prishtinë është dëmtuar tubi i ujit, polietilen, me diametër fi 250 mm dhe, si pasojë e dëmtimit të tij, disa lagje kanë mbetur pa ujë të pijshëm.
Lagjet që kanë mbetur pa ujë të pijshëm janë: "Bajram Bahtiri", rruga e "Llapit", rruga "Lidhja e Prizrenit" te "Tregu i Gjelbër", rruga "Ramë Govori", rruga "Drenica 1", rruga "Vëllezërit Fazliu", "Mbreti Piro", "Mic Sokoli" dhe disa rrugica në atë zonë.
Në njoftimin e KRU "Prishtina" theksohet se ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit janë në vendin e ngjarjes me të gjitha mjetet e punës për sanim. "Për shkak të pengesave të shumta të kabllove elektrike të vendosura mbi atë gyp dhe thellësisë së gypit prej rreth dy metrash punët janë vështirësuar në ndërkohë, por ekipet me çdo kusht dhe punë të pandërprerë, në afatin sa më të shkurtër do ta rikthejnë furnizimin me ujë të pijshëm për lagjet dhe rrugët 'Bajram Bahtiri', rruga e 'Llapit', rruga 'Lidhja e Prizrenit' te 'Tregu i Gjelbër', rruga 'Ramë Govori', rruga 'Drenica 1', rruga 'Vëllezërit Fazliu', 'Mbreti Piro', 'Mic Sokoli' dhe disa rrugica në atë zonë", ka njoftuar KRU "Prishtina".
Sipas kësaj kompanie, vështirësitë e dala përgjatë sanimit të defektit kanë zgjatur punimet e paplanifikuara. "Kërkojmë mirëkuptim nga të gjithë konsumatorët e zonave të lartcekura", theksohet në njoftimin e KRU "Prishtina".

## ATK-ja bën tërheqjen e numrave potencialë fitues për tremujorin e fundvitit të 2019-s

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë tërheqjen e numrave potencialë fitues për rimbursim të qytetarëve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë për periudhën e TM4 2019. "Tërheqja e numrave potencialë fitues është transmetuar drejtpërdrejt në RTK, ku janë tërhequr tre numra potencialë fitues, ashtu siç është e specifikuar në Udhëzimin Administrativ 01/2017. Numri i qytetarëve potencialë të cilët kanë fituar për këtë periudhë është 2 743. Qytetarët të cilët posedojnë numrin potencial fitues të përzgjedhur nga tërheqja, plikon me kuponë fiskalë së bashku me të dhënat e aplikimit, duhet ta dorëzojnë fizikisht të mbyllur, në njërën nga drejtoritë regjionale të ATK-së, brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas publikimit të listës në uebfaqe të ATK-së", thuhet në njoftimin e ATK-së, duke shtuar se dorëzimi i plikove duhet të bëhet nga data 10 shkurt deri më 14 shkurt 2020, nga ora 8:00 deri në orën16:00.



# Heqja e barrierave tregtare, në funksion të dialogut dhe normalizimit




PRISHTINË, 7 SHKURT - Eliminimi i barrierave tregtare ndërmjet shteteve të rajonit, sidomos ato me probleme, siç janë Kosova dhe Serbia, do të krijonte një ambient më të mirë për bizneset në përgjithësi dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës, thonë përfaqësues të bizneseve në Kosovë dhe ekspertë të kësaj fushe. Sipas tyre, zgjidhja e çështjeve të hapura politike, në veçanti ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, mund të shihet edhe në favor të zhvillimit më të madh ekonomik.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se barrierat tregtare të vendosura ndër vite ndërmjet shteteve e kanë penguar zhvillimin ekonomik në përgjithësi si në Kosovë ashtu edhe në vendet e rajonit. "Bizneset mund të luajnë një rol më të madh sa i përket dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pasi që në fund të fundit bizneset e kanë barrën e krijimit të vendeve të reja të punës dhe ato mund të bëjnë shumë më tepër edhe në aspektin e afrimit të të dyja shteteve dhe lëvizjes drejt raporteve më të mira ndërshtetërore dhe ndërfqinjësore, që është edhe parakusht për integrimin e shteteve të rajonit në Bashkimin Evropian", thotë Zeka.

Barrierat e shumta tregtare mes shteteve të rajonit të vendosura edhe nga Kosova, siç është rasti me taksën 100 për qind për importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, sipas Arian Zekës, janë në kundërshtim edhe me zotimet që janë ndërmarrë nga Kosova në rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, siç është Marrëveshja për Tregti të Lirë CEFTA, anëtare e së cilës Kosova është që nga viti 2007.

Qeveria e kaluar e Kosovës në krye me ish-kryeministrin Ramush Haradinaj në nëntor të vitit 2018 pati vendosur taksë doganore 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Kjo taksë ishte bërë pengesë për vazhdimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Eksperti i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se duhet të kuptohet që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk ka alternativë. Kurse vendosja e barrierave mes shteteve, thekson ai, nuk i bën favor zhvillimit ekonomik të asnjë vendi. "Është koha kur duhet që populizmi t'i takojë së kaluarës pasi që ne jemi në një periudhë të zhvillimit ekonomik. Ta kemi prioritet sundimin e rendit dhe ligjit, ta kemi prioritet partneritetin, qoftë në rajon, qoftë në Evropë, qoftë me ShBA-në. Nuk i duhet të ardhmes së Kosovës nëse mendohet si të bëjmë barriera. Mjeshtëria dhe vizioni politik respektohet atëherë kur gjejmë alternativa si të eliminohen barrierat dhe si të përdoret ekonomia si një mekanizëm i përafrimit, si një mekanizëm që ndryshon imazhin e Ballkanit Perëndimor", thotë Gërxhaliu.

Ai thekson se ekonomia duhet të përdoret si mekanizëm kyçë për të ardhmen. Kosova, Serbia, por edhe vendet e tjera të rajonit, thotë Gërxhaliu, nuk kanë kohë për të humbur dhe problemet duhet t'i takojnë së kaluarës. "Me këtë mbështetje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe rekomandimet që vijnë nga miqtë ndërkombëtarë besoj se kryeministri Albin Kurti do ta ketë më të lehtë të marrë vendime që do ta garantonin ardhmërinë dhe jo që ta zbukurojnë të kaluarën", shprehet Gërxhaliu.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind të vendosur nga qeveria e kaluar për importet nga Serbia, me reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar.

Arian Zeka nga OEAK-u thotë se është e nevojshme që tarifa të hiqet pasi që është në kundërshtim me frymën e zotimeve që Kosova ka ndërmarrë në raport me shtetet e tjera. "Tarifa, si e tillë, duhet të rishqyrtohet dhe të hiqet menjëherë nga ana e qeverisë së re ashtu që të mund të kalojmë në një fazë tjetër ku diskutohet për raporte të reja, edhe tregtare, edhe çfarëdo lirie tjetër që mund të diskutohet. Duhet të flasim për eliminimin e të gjitha problemeve të natyrës politike që kanë ekzistuar në të kaluarën, të cilat pastaj do ta mundësonin edhe njohjen e dokumentacionit, edhe njohjen e procedurave të plota që lëshohen nga njëri shtet dhe njihen nga shteti tjetër", thotë Zeka.

I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, gjatë vizitës së tij në Kosovë pati theksuar se administrata e presidentit amerikan Donald Trump "është e fokusuar në krijimin e vendeve të punës nga bizneset amerikane, duke cekur që komuniteti i biznesit është pjesa më e rëndësishme e zgjidhjes së problemit Serbi - Kosovë".

Kosova përballet me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik. Viti 2019 u përmbyll me një rritje ekonomike prej 4.2 përqindësh, e cila ka qenë e pamjaftueshme për të adresuar problemin e papunësisë me të cilin përballen të rinjtë.

Papunësia në Kosovë është në shkallën rreth 30 për qind dhe prek kryesisht të rinjtë. Të dhënat e fundit të Doganës së Kosovës të dërguara Radios Evropa e Lirë tregojnë se si pasojë e mospërputhjes ndërmjet vlerës së eksporteve dhe të importeve deficiti vjetor tregtar në Kosovë ka arritur në shifrën e më shumë se 3 miliardë eurove.

Brenda një viti Kosova ka importuar mallra nga vende të ndryshme të botës në vlerë prej më shumë se 4 miliardë eurosh, derisa ka eksportuar jo më shumë se 340 milionë euro.

## 35 milionë euro për linjën e re elektropërçuese në mes të Maqedonisë dhe Shqipërisë



SHKUP, 7 SHKURT - MEPSO do të investojë 35 milionë euro në linjë të re largpërçuese 400 kilovatë që do ta lidhë sistemin elektropërçues në mes të Maqedonisë dhe Shqipërisë si dhe një stacion të ri transformator në afërsi të Ohrit. Në këtë mënyrë korridori i energjisë Lindje - Perëndim do të vihet në veprim të plotë, që do të thotë transit i energjisë elektrike nga Bullgaria përmes Maqedonisë dhe Shqipërisë deri në Itali. Lidhja rajonale e sistemeve të përçimit të energjisë është një interes afatgjatë, strategjik për çdo shtet. Marrëdhëniet me fqinjët nënkuptojnë stabilitet elektroenergjetik, themeli i çdo ekonomie të prosperuar", ka deklaruar Eva Shukleva, drejtoreshë e përgjithshme e MEPSO-s.

# IKShPK-ja: Rreziku për depërtimin eventual të koronavirusit në Kosovë mbetet i ulët

Deri më tani në nivel global janë raportuar gjithsej 31 503 raste të konfirmuara me koronavirus. Në Kinë gjithsej 31 217 raste të konfirmuara me 637 vdekje. Jashtë Kinës janë raportuar 286 raste me një rast vdekje në Filipine. Ndërkaq në Evropë janë raportuar 31 raste. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se rreziku për depërtimin eventual të këtij virusi në Kosovë vazhdon të mbetet i ulët

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHKURT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se është duke e përcjell në mënyrë aktive situatën epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në veçanti është duke monitoruar nga afër epideminë e sëmundjes respiratore të shkaktuar nga një koronavirus i ri i identifikuar për herë të parë në Wuhan, Provinca Hubei, Kinë. "Duke u bazuar në situatën aktuale epidemiologjike, informatat nga terreni, përgatitjet e institucioneve shëndetësore për t'u përballur me rastet eventuale të koronavirusit, mungesa e linjave ajrore direkte me Kinën, rreziku për depërtimin eventual të virusit në Kosovë vazhdon të mbetet i ulët. IKShPK, Departamenti i Epidemiologjisë, po bën mbikëqyrjen aktive dhe gjurmimin e rasteve", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike ka bërë me dije se ka përforcuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së koronavirusit të ri. "Është ngritur shkëmbimi i informatave ndërinstitucionale në mes të Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar, ShSKUK-së, AUV-së, QKMF-ve, Policisë së Kosovës, FSK-së dhe MAShT-it. Instituti Kombëtar ka rekomanduar të gjitha institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Policinë e Kosovës, AUV-në dhe punëtorët shëndetësorë që ta ngrehin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë. Çdo rast i dyshimtë i sëmundjes duhet të raportohet nga Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe institucionet e tjera shëndetësore publike dhe private, brenda 24 orëve (në kohë reale, sa më parë që është e mundshme me mjetin e komunikimit më të shpejtë) në Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike dhe drejtpërsëdrejti në IKShPK", është theksuar në këtë njoftim.
IKShPK-ja ka theksuar se të gjitha institucionet shëndetësore duhet të vazhdojnë ta zbatojnë gatishmërinë e tyre për emergjencat shëndetësore, në përputhje me Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit (2005), rekomandimet e OBSh-së dhe ECDC-së. "Janë ngritur ekipe në të gjitha QKMF-të e Kosovës në gjendje gatishmërie që për çdo rast të dyshimtë të udhëtarëve që hyjnë në Kosovë përmes kufijve tokësorë do t'i vizitojnë menjëherë dhe rekomandojnë për hapat e mëtutjeshëm të procedurave mjekësore sipas planit të gatishmërisë së Institutit Kombëtar. Në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është ekipi mjekësor, me të cilin jemi në kontakt të vazhdueshëm për mbikëqyrjen e situatës në rast të shfaqjes së personave të dyshimtë me sëmundje ngjitëse.




Ekuipazhi i aeroplanit duhet t'i ndjekë procedurat operacionale të rekomanduara nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA) në lidhje me menaxhimin e personave të dyshimtë me sëmundje ngjitëse në bordin e aeroplanit", thuhet në këtë njoftim.
Sipas IKShPK-së, për të gjitha rastet e dyshimta me koronavirus Instituti Kombëtar ka sasi të nevojshme të kiteve për detektim të Novel Coronavirusit 2019 nga Instituti Pasteur në Paris, France, në kuadër të projektit rajonal Medilab Secure. "Në rast të paraqitjes së rastit të parë dhe fillimit të rritjes së numrit të rasteve Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka përpiluar tashmë planin e kontingjencës dhe planin e gatishmërisë dhe reagimit për 2019-nCoV është ndërtuar në bazën e pesë pjesëve të lidhura ngushtë mes vete me qëllim të vetëm: menaxhimin e drejtë të rasteve. Instituti Kombëtar do t'i informojë rregullisht institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë e Emergjencave dhe OBSh-në për ecurinë epidemiologjike të Novel Coronavirus (2019- nCoV) në Republikën e Kosovës", është theksuar një njoftimin e IKShPK-së.
Në nivel global janë raportuar gjithsej 31 503 raste të konfirmuara me koronavirus. Në Kinë gjithsej 31 217 raste të konfirmuara me 637 vdekje, jashtë Kinës janë raportuar 286 raste, me një rast vdekje në Filipine. Në Evropë janë raportuar 31 raste me koronavirus të konfirmuar në Gjermani, Francë, Itali, Mbretëri të Bashkuar, Belgjikë, Rusi, Finlandë, Spanjë dhe Suedi.



## Masat e parandalimit

1. Shmangia e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes.
2. Larja e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre.
3. Shmangia e prekjes së fytyrës dhe mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Hidhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave.
4. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit.
5. Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes.
6. Të evitohen vendet e mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.
7. Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë brenda dy javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore.
8. Brenda mjediseve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës.
9. IKSHPK rekomandon të gjithë që të mos udhëtojnë drejt Kinës, nëse nuk e kanë të domosdoshme.

Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të situatës epidemiologjike me koronavirus në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë ndryshime dhe për to do të informoheni me kohë.

## Reka i kërkon Barishiqit mbështetjen e Kroacisë për liberalizim

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të premten në takim ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barishiq, pasi që Kroacia kryeson me BE-në. Sipas një njoftimi të kësaj ministrie, takimi u mbajt në frymën e bashkëpunimit dhe të koordinimit për prioritetet kyçe dhe perspektivën evropiane të Kosovës.
Ambasadorja Barishiq e ka njoftuar ministrin Reka për prioritetet e zgjerimit dhe përgatitjet e Kroacisë si udhëheqëse e Samitit të Zagrebit që organizohet në maj.
Me këtë rast ministri Reka ka potencuar rëndësinë e koordinimit të përbashkët dhe ka kërkuar mbështetje nga Kroacia si vend mik i Kosovës për dinamizëm të Agjendës Evropiane, respektivisht për finalizim të liberalizimit të vizave për Kosovën, si prioritet afatshkurtër, ndërsa në aspektin afatgjatë, avancimin e administratës së Kosovës për aplikim për statusin kandidat në BE.
Më tutje, gjatë takimit u rikonfirmua bashkëpunimi dhe u diskutua për avancimin e potencialit në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy vendeve tona.



# Fillojnë punimet për krijimin e hapësirave publike te Liqeni Akumulues në Suhadoll



MITROVICË, 7 SHKURT (ER) - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se rregullimi dhe organizimi i hapësirave publike përreth Liqenit Akumulues në Suhadoll do të ofrojë mundësi rekreative, pushimore, hapësira gjelbëruese, kënde të lojërave për fëmijë, kënde për ushtrime fizike fushore, shtigje për ecje, vrapim e çiklizëm, të cilat do t'i japin një pamje jashtëzakonisht të bukur qytetit dhe liqenit, duke e bërë kështu më atraktiv për vizitorët.



# Në Kamenicë rrugët janë të kalueshme

KAMENICË, 7 SHKURT (ER) - Komuna e Kamenicës ka njoftuar se të premten të gjitha rrugët kryesore në këtë komunë kanë qenë të hapura nga bora. Kjo ka ardhur si rezultat i angazhimit dhe punës së palodhshme të kompanisë së kontraktuar, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Ministrisë së Infrastrukturës. "Kompania kontraktuese bashkë me ekipet e tjera do të ndërhyjnë në këto lokalitete: Busavatë në Lagjen Prokurogja, Tërstenë, Lisockë, Krinidell, Marocë dhe Karaqevë. Lusim të gjithë qytetarët të tregojnë mirëkuptim", është thënë në njoftimin e kësaj komune.

# Lansohet programi 'Vizitat në shtëpi' në Gjakovë



GJAKOVË, 7 SHKURT (ER) - Lansohet programi 'Vizitat në shtëpi' në Komunën e Gjakovës. Sipas një njoftimi për media të kësaj komune, falë lansimit të programit 'Vizitat në shtëpi' tani e tutje shumë nëna dhe fëmijë në këtë komunë do të kenë shëndet dhe mirëqenie më të mirë.

Ky program realizohet nga Ministria e Shëndetësisë në Kosovë me përkrahje të UNICEF-it dhe Ambasadës së Luksemburgut si dhe mbështetet nga Komuna e Gjakovës, përkatësisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Të pranishëm gjatë lansimit ishin kryetari i komunës, Ardian Gjini, ushtruesi i detyrës së drejtorit të DShMS-së, Ferdinand Kolaj, sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqi, ambasadorja e Luksemburgut në Kosovë, Natacha Gomes, shefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, stafi i QKMF-së si dhe përfitues të programit. Donatorët janë përkujdesur që për realizimin e vizitave, mjekëve dhe infermierëve të QKMF-së t'u sigurohet edhe një automjet.

# Komuna e Skenderajt organizon takim informues për legalizimin e ndërtimeve

SKENDERAJ, 7 SHKURT (ER) - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se më 11 shkurt do ta mbajë një takim informues me qytetarët e kësaj komune për çështjen e legalizimeve të ndërtimeve. "Të dashur qytetarë të Skenderajt, me qëllim të informimit tuaj në lidhje me procedurat për legalizimin e ndërtimeve tuaja, shtëpive dhe ndërtesave, Komuna e Skenderajt do ta mbajë takimin e parë me qytetarë, më datën 11. 02. 2020, duke filluar nga ora 13:30, në sallën e Kuvendit Komunal. Me ligjin e trajtimit të ndërtimeve pa leje do të trajtohen të gjitha ndërtimet e ndërtuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji më 05. 09. 2018. Taksa për legalizimin e ndërtimit është shumë e lirë, 1 euro për m2 për kategorinë 1 (shtëpi) dhe 2 euro për m2 për kategorinë 2 (ndërtesa). Ndërtimi juaj pas legalizimit nuk rrezikon të rrënohet!", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.




## Kryetari i Junikut nënshkruan memorandum për efiçiencën e energjisë

JUNIK, 7 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi në kuadër të projektit "Iniciativat testuese për investimet e njësive të banimit në efiçiencën e energjisë", që si objektiv kryesor ka ta inkurajojë zbatimin e masave të efiçiencës së energjisë dhe të burimeve të ripërtritëshme të energjisë në sektorin e banimit përmes pakos ndërhyrëse HER.

Pakoja ndërhyrëse parasheh ndërhyrjet në ruajtje të energjisë, investime këto me fokus në renovimet për efiçiencë në njësitet e banimit, kryesisht te rastet sociale dhe te rastet ku gruaja është kryefamiljare. Ky projekt është financuar nga Fondacioni i Mileniumit të Kosovës.



## Trumpi konfirmon vdekjen e një udhëheqësi të Al-Qaidas në Jemen




Uashington, 7 shkurt - Presidenti amerikan, Donald Trump, konfirmoi të enjten vdekjen e një udhëheqësi të al-Qaidas në një sulm me dron të Shteteve të Bashkuara në Jemen.
Presidenti Trump tha se Shtetet e Bashkuara kryen një operacion të suksesshëm kundër terrorizmit duke vrarë Qasim al-Rimin, themeluesin dhe drejtuesin e al-Qaidas në Gadishullin Arabik (AQAP). Ai ishte zëvendës i udhëheqësit të al-Qaidas Ayman al-Zawahiri. "Nën drejtimin e Rimit, AQAP-i kreu dhunë të paskrupullt ndaj civilëve në Jemen dhe u përpoq të kryejë dhe të frymëzojë një numër sulmesh kundër Shteteve të Bashkuara dhe forcave tona", tha presidenti Trump. "Vdekja e tij kufizon më tej AQAP-in dhe lëvizjen globale të al-Qaidas, dhe na sjell më afër eliminimit të kërcënimeve që këto grupe paraqesin për sigurinë tonë kombëtare", tha ai.
Rimi iu bashkua al-Qaidas në vitet 1990, duke punuar në Afganistan për Osama bin Ladenin dhe ishte i lidhur me disa komplote që shënjestronin amerikanët.
Vrasja e Rimit është e treta me radhë në operacionet amerikane kundër terrorizmit në muajt e fundit. Në tetor, Shtetet e Bashkuara vranë themeluesin e Shtetit Islamik, Abu Bakr al-Bagdadi. Në janar, një sulm ajror vrau komandantin e lartë iranian Qassem Soleimani.

# Pete Buttigies, demokrati më i ri që ia mësyn Shtëpisë së Bardhë

Pete Buttigies, si më i riu në mesin e kandidatëve të shumtë të demokratëve për president të ShBA-së, ka fituar vëmendje të veçantë të mediave, i cili fushatën po e ndërton mbi idenë e ndërrimit të brezave në Shtëpinë e Bardhë



Uashington, 7 shkurt - Në mesin e shumë demokratëve që po konkurrojnë për postin e kandidatit për president të ShBA-së, vëmendje të veçantë të mediave ka fituar Pete Buttigieg, 38 vjeç, i cili fushatën po e ndërton mbi idenë e ndërrimit të brezave në Shtëpinë e Bardhë.
Në fillim të fushatës së tij për kandidat presidencial në janar të vitit 2019, Buttigieg ka qenë relativisht i panjohur si kryetar në shtetin e Indianas në qytetin South Band, me vetëm 100 mijë banorë, shkruan "New York Times".
U shkollua në Harward, pastaj në Oxford, falë një burse dhe më vonë shërbeu si oficer zbulimi në forcat rezervë të marinës, si dhe punoi si konsulent në kompaninë McKinsey. Në politikë u fut në vitin 2017, kur pa ndonjë sukses kandidoi për president të komitetit nacional të demokratëve.
Si më i riu në mesin e kandidatëve të shumtë të demokratëve për president të ShBA-së, premton se do të ndërtojë urën drejtë epokës së re të politikës amerikane. Ai gjithashtu dallohet si kandidati i parë që kërkon rritjen e numrin e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të SHBA-ve, si dhe është treguar si njëri nga njerëzit më të shkathtë në mbledhjen e fondeve të majme në fushatë.
Siç raporton "New York Times", ajo çfarë e dallon më shumë Buttigieg nga kandidatët e tjerë në garë, është fakti që është personi i parë që haptazi ka deklaruar që është homoseksual dhe që ka thënë se planifikon që drejtpërdrejt nga posti i kryetarit të komunës të zhvendoset në Shtëpinë e Bardhë.
Në vitin 2018, Buttigieg u martua me partnerin e tij Chaseten Gelzman, arsimtarin nga Michigan, i cili prej asaj kohe është aktiv në fushatën e tij, duke mbledhur para dhe marrë pjesë në evenimente në mbarë ShBA-në, duke promovuar kandidaturën e Buttigieg.
Bernie Sanders dhe Pete Buttigieg kanë marrë pothuajse të njëjtin numër të votave për nominim për kandidat për president nga radhët e demokratëve në Iowa, ku mbi 97 për qind të votave janë numëruar.
Sipas rezultateve më të reja Buttigies ka 26,2 për qind të votave, derisa Sanders i ka 26,1 për qind. Rezultatet tregojnë që Buttigies, ish-kryetari i qytetit South Bend në Indiana, ka marrë më së shumti vota dhe është para Sandersit, senatorit progresiv nga Wermonti.
Zgjedhjet e mbajtura në Iowa gjatë javës së kaluar kanë shënuar vonesa në rezultate për shkak të disa problemeve teknike, meqë aplikacioni në të cilin është dashur të jepen të dhënat nuk ka punuar, por pretendohet se edhe ishte hakuar.

## Turqia nuk do të tërhiqet nga Idlibi i Sirisë



Ankara, 7 shkurt - Turqia nuk e ka në plan t'i tërheqë trupat nga pikat e vëzhgimit, në rajonin e Idlibit në Siri, edhe pse tri nga këto pika gjenden në zonat e kontrolluara nga qeveria siriane. Lajmi bëhet i ditur nga agjencia "Reuters", e cila thirret në burime brenda institucioneve turke të sigurisë.
Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka kërcënuar se do t'i zmbrapsë trupat siriane në Idlib, nëse nuk tërhiqen deri në fund të muajit. Deklarata e tij u bë pasi tetë ushtarë turq u vranë nga bombardimet e forcave qeveritare siriane më 3 shkurt.
Forcat e presidentit Bashar al-Asad po bëjnë përpjekje për të kthyer kontrollin në rajonin e Idlibit dhe disa pjesë të Alepos. Këto rajone janë territoret e fundit në të cilat kanë ende kontroll rebelët antiqeveritarë, të cilët gëzojnë mbështetjen e Turqisë. Rusia dhe Irani kanë mbështetur forcat e Assadit në konfliktin sirian.
Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan i ka thënë të martën homologut të tij rus, Vladimir Putin se Ankaraja do të përgjigjet "ashpër" nëse do të ketë një tjetër sulm sirian.
Në Turqi gjenden rreth 3.5 milionë refugjatë sirianë. Ankaraja ka frikë se mund të ndodhë një fluks tjetër i refugjatëve pas përshkallëzimit të dhunës në Idlib.

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

# NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:
**• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.
Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.
**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

# NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:
**• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.
We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.
**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

# OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajucćeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:
**• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.
Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajucćeg društva na gore navedenu novu adresu glavne







**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**
Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës
**Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net**




# Gjuha, letërsia dhe kultura shqiptare në dijen evropiane

## Parafjalë

*Studiuesja e gjuhës dhe letërsisë shqipe, Mimoza Hasani Pllana, ka hyrë në dijen e letrave shqipe me një libër studimor, analitik dhe estetik, "Shtegtimi i shqipes në Europë". Ky studim paraqet një pamje të parë e të rrallë të ekzistencës, mësimit e studimit të shqipes në vendet evropiane, madje jo vetëm në vendet ku shqipja tashmë është pjesë e inaugurimit si institucion, por edhe në vendet e tjera ku gjuha jonë gjurmohet e studiohet edhe në nivelin e kreacionit.*

**Fitim VELIU**

Mimoza, në këtë libër arrin të sjell të dhëna biografike, bibliografike, studime dhe analiza të ndryshme për gjuhën dhe letërsinë shqiptare në vendet evropiane, nëpërmjet shumë intervistave të autorëve, studiuesve, të cilët punojnë për dokumentimin dhe prezantimin e gjuhës dhe letërsisë shqiptare tek lexuesit e huaj, evropianë dhe botërorë. "Shtegtimi i shqipes në Europë", sjell kujtesën tonë kolektive në rrafshin ndërkombëtar, si shije letërsia dhe si dije gjuha e historia. Autorja, në këtë libër sjell për lexuesin shqiptar praninë e shqipes në institucionet akademike të vendeve evropiane, si: Austri, Bullgari, Çeki, Francë, Finlandë, Greqi, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kroaci, Poloni, Rusi, Slloveni, etj. Prania e shqipes në këto vende dëshmon jo vetëm praninë e gjuhës sonë si hije, por si një shije e vërtetë që lexuesi evropian e mëson dhe e studion paralelisht me gjuhën amë.

### Letërsia dhe kultura si ndikim

Libri në fjalë, brenda materies gjuhësore e letrare, më së miri e tregon intencën e studiuesve të huaj për gjuhën, letërsinë dhe kulturën tonë. Albanologu gjerman, Hans Joachim Lanksch, në intervistën e tij me studiuesen shqiptare, Mimosa Hasani, thekson se "Kultura shqiptare, sidomos ajo veriore si dhe zakonet e viseve e fiseve, janë mjaft tërheqëse për studim dhe fakti se si kjo kulturë patriarkale mbijeton ende përballë kohës moderne", përbëjnë një interesim për studim të thelluar". Sa i përket gjuhës dhe letërsisë shqiptare, Hans e sheh gjuhën shqipe në variantin gegë dhe idiomin jugor. Sipas Hans "poezia e shkruar në këto anë, e sidomos poezia e shkruar në gegërisht, frazeologjia e saj, që e krijoi gegërishten letrare janë një pasuri me vlerë". Hansi gjatë kësaj interviste, gjuhën shqipe, si shije estetike e sheh te Lasgush Poradeci, Kuteli, Pashku, Trebeshina e Kadareja, por në vlerësimet e tij, Hans mendon se letërsia shqipe është e tërë si vlerë, duke përjashtuar krijimin e skemave të autorëve përfaqësues. Ai mendon se 'Kadareja ka meritat që i ka, por shqiptarët kanë jo vetëm një autor, por një letërsi të tërë'. Është ky mendimi më sistematik dhe etik lidhur me përfaqësimin e letërsisë shqiptare në Europë, pra kur tashmë letërsia jonë nuk shihet vetëm tek një autor, por si një amzë e tërë autorësh, si vlerë e përbashkët, si shumësi, si objekt e asnjëherë si subjekt.

### Zemra si kategori estetike

Gjuha dhe letërsia shqiptare në Austri, Francë dhe vende të tjera, tashmë i tejkalon nivelet elementare të mësimit, studimit e përfaqësimit, duke u ngritur në nivelin e ballafaqimit me letërsitë e tjera simotra. Poeti austriak, Kurt Gostentsching, ka realizuar shumë përkthime të letërsisë shqipe në gjuhën gjermane dhe ai ka vetëm një motivim për këtë "Shqipja është dashuria ime e vjetër", thotë ky poet në intervistën e tij me studiuesen Pllana. Mendimi i Kurt G. tregon një mendim sistematik që ka në thelb shijen e letërsisë përballë maksimalizimit e përfitimit material. Letërsinë shqipe në gjuhën gjermane, Kurt e ka bërë në bazë të përvojave të leximit të thellë, duke e përjashtuar kritikën letrare dhe shtëpitë botuese, sepse sipas tij "Kritika letrare fshihet pas nocioneve të ndërlikuara dhe të vetështpikura dhe të pakuptueshme për lexuesin, duke i përjashtuar kategoritë e zemrës dhe të shpirtit, realitetin e të cilave nuk e kupton ose nuk e pranon, kurse shtëpitë botuese ia kanë shitur shpirtin maksimalizimit të përfitimit".

### Shqipja në INALCO

Studiuesja Mimoza Hasani, në librin e saj "Shtegtimi…", në intervistën e saj me Profesorin Tomorr Plangarica, mësimdhënës në Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve të Lindjes, ku shqipja tashmë studiohet në tri nivelet themelore: licence, master dhe doktoratë. Në këtë institucion, gjuha shqipe mësohet në mesin e 100 gjuhëve të tjera të botës. Sipas prof. Tomorit "Shqipëria, historia dhe kultura e saj, heronjtë dhe bëmat e tyre kanë qenë të pranishme edhe në penat e klasikëve francezë, te Ronsari, Lamartini, Ogyst Dozoni, Mario Roku etj. Gjuha dhe letërsia shqipe, sot, në hapësirën franceze kanë një prani të kënaqshme jo vetëm në nivelin e mësimit, por edhe të leximit, sepse shumë autorë shqiptarë, tashmë janë përkthyer në frëngjisht, duke përfshirë edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit. Shkolla letrare franceze, identifikohet edhe me studiuesin shqiptar. Eriona Tartari tashmë ka dhënë shenjat e saj themelore në këtë drejtim letrar, ndonëse modeli sipas saj është i kundërshtueshëm. Ajo e sheh depërtimin e letërsisë shqipe jashtë kufijve sipas konceptit të "dygjuhësisë dhe përkthimit letrar".

### La Sapienza

Koliqi, tregimtari dhe novelisti shqiptar, tashmë i ka lënë gjurmët e tij në Itali, në një qendër kulturore të dijes europiane. Studiuesi arbëresh, Elio Miracco, në bisedë me studiuesen e letërsisë shqipe, Mimoza P., na sjell kujtesën e gjuhës shqipe në rrjedhën arbërore/shqiptare, si radhë e si farë, që tashmë ka lënë gjurmë në Italinë e arbëreshëve tanë, të cilët e ruajtën gjuhën dhe traditën amë. Elio Miracco, prof. i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Institutin e Studimeve Shqiptare në Universitetin e Romës "La Sapienza, tregon për Koliqin, pra ndikimin e tij, si një shenjë e gjallë shqiptare tek arbëreshët. Diskurset e Koliqit ishin "mahnitëse në interpretimet e vargjeve të Fishtës dhe autorëve të tjerë.

### Tradita albanologjike në Bullgari

Fati shqiptar, si nyje lidhet me autorët e shoqërisë kulturore "Drita", "Dëshira" dhe "Gjergj Kastrioti", që kishin vepruar në Bullgari. Studiuesja sistematike e gjuhës dhe letërsisë shqipe, në Bullgari Rusana Bejleri, së fundmi ka sjell një libër akademik "Letërsia shqipe si pasqyrë e shpirtit të popullit". Ky libër trajton letërsinë shqipe të traditës në relacion me autorët rimarrës të kësaj tradite. Në studimet e saja, Bejleri ka hetuar stilin e Migjenit me atë të poetit bullgar, Smirnenskin, ku trajtohet motivi i varfërisë ekstreme. Kjo studiuese në intervistën e saj me studiuesen shqiptare, Mimoza Hasani flet edhe për praninë e autorëve shqiptarë të përkthyer tashmë në gjuhën bullgare. Sipas Rusanës "Autorët e përkthyer shqiptarë janë mbi 50". Shqipja tashmë ka një traditë në gjuhën bullgare, si shenjë e madhe kulturore në rrafshin evropian.

### Në vend të përfundimit

Libri "Shtegtimi i shqipes në Europë", është një ndër ngjarjet më të mëdha kulturore/letrare shqiptare. Një studim i tillë, i pari i këtij lloji ndër ne, dëshmon punën e studiueses Mimoza Hasani Pllana për pasionin e studimit dhe punën e hulumtimit. Tashmë Mimoza, me këtë libër i sjell lexuesit shqiptarë gjuhën e tyre amë në rrafshin ndërkombëtar, si gjuhë e mësimit, studimit dhe leximit. Gjuha shqipe tashmë me këtë libër ka një jetë përtej shtratit të saj të lindjes. Libri sjell studiues, profesorë e hulumtues, të cilët tashmë janë bërë zëra shqipfolës për lexuesit e huaj, të cilët tani historinë, gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare mund t'i lexojnë edhe në gjuhën e tyre amë. Shpirti shqiptar, pra gjuha, letërsia dhe kultura jonë e shtrinë frymën e saj falë penës së artë të shkrimtarëve, të cilët jetojnë e jehojnë me diskurset e tyre madhështore, si: Fishta, Konica, Noli, Migjeni, Samiu, Naimi, Kuteli, Koliqi, Lasgushi, Camaj, Trebeshina, Din Mehmeti, Kongoli, Kadare, Qosja, Kujtim Shala, Kasëm Trebeshina etj.

Bisedë me studiuesin dhe përkthyesin arbëresh, Giuseppe Antonio (Zef) Chiarmonte

# Mësimi i gjuhës shqipe dhe varianteve arbëreshe



**Bisedën e realizoi: Mimoza HASANI PLLANA**

*Z. Chiarmonte, keni mbaruar studimet për gjuhë, letërsi shqipe dhe filozofi, por edhe keni marrë pjesë në disa kurse lidhur me studimet ballkanike dhe religjionin. Sipas jush, si ndërlidhen këto fusha të ndryshme shoqërore?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Tek arbëreshët e kulturuar, sidomos të moshës sime, vihet re se kjo ndërlidhje initeresash nuk është assesi një gjë e rrallë.Kultura jonë është ngushtësisht e lidhur me kishën, si një factor që vjen prej lidhjes në mes tyre, në shtjellat e kohës. Një kishë e veçantë, ngase i takon traditës bizantine dhe prandaj ndryshon nga tradita latine, e cila është e ndjekur nga shumica dërrmuese e popullatës italiane, në mes të cilës arbëreshët, aty-këtu, jetojnë, duke bërë shpesh një jetë ishullore. Për më shumë, gjuha arbëreshe, përveçse është përdorur në këngat fetare, në një periudhë u kultivua nëpër institucionet kishtare. Të vetmet institucione publike që deri vonë patën për qëllim ruajtjen, përdorimin dhe kultivimin e gjuhës arbëreshe. Le të kujtojmë këtu Lek Matrangën, De Radën, Skiroin. Kisha, së bashku me veshjet, me gjuhën e me zakonet identifikojnë arbëreshin e rëndomtë në mesin e krahinave italiane ku jetojnë. Unë i takoj pikërisht kësaj trashëgimie dhe mburrem me të.

*Historia e letërsisë shqipe, njeh dhe respekton njërin prej prijatarëve të Rilindjes Kombëtare, poetin arbëresh Jeronim De Rada. De Rada, përveç kontributit të jashtëzakonshëm letrar la pas vetes edhe kontributin arsimor në katedrën për mësimin e gjuhës shqipe brenda kolegjit në qytetin e Shën Mitërit (Kozencë), rajonit të Kalabrisë. Si funksionon sot kjo katedër dhe katedrat e tjera të albanologjisë brenda shtetit italian?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Katedrat e gjuhës shqipe, ku trajtohen edhe variantet arbëreshe, janë një risi e kohës moderne. Mësimi që dha De Rada në Kolegjin e Shën Adrianit në Shëmitër Korone në Kalabri, merrej vetëm me arbërishten, ngase aso kohe gjuha shqipe pak njihej ndër arbëreshë, përveçse ishte ende e pazhvilluar. Megjithatë, shkrimtarët tanë e njihnin patjetër veprën e Kristoforidhit. Shndërroi pastaj Kolegji në Lice Klasik shtetëror dhe ajo katedër njohu një numër bukur të madh studentësh nga Shqipëria. E njëjta gjë ndodhte edhe te qendra kulturore tjetër, në Seminarin Arbëresh në Palermo të Sicilise, ku edhe kishte mësim të arbërishtes dhe botohej FJALA E T'YN'ZOTI nga Pal Skiroi, zbuluesi i Mesharit, (ndonëse si zbulues i parë njihet Gjon Nikollë Kazazi, shënim imi- M. Hasani Pllana). Ky institucion u shua! Për fat të mirë, mësimi i shqipes, që në Itali jepej vetëm në Padova dhe Napoli, domethënë shumë larg vendbanimeve arbëreshe, u ripërtëri në Romë me Koliqin dhe në Palermo me Gaetano Petrottën, papas arberesh, dhe me At Valentinin. Më vonë, me krijimin e Universitetit në Kalabri, u shtua një tjetër katedër për gjuhën shqipe dhe kështu në shumë universitete të tjera, gjegjësisht në jugun e Italisë për hir të pranisë së banorëve arbëreshë. Katedrat që sot janë më në zë, ajo e Palermos dhe ajo e Kozencës, dhe po ashtu të tjerat, nuk mund t'i shmangen problematikës arbërisht/shqip. Nga njëra anë ato do të merren me gjuhë e letërsi shqipe, sipas programeve shtetërore, nga ana tjetër pothuajse nuk ndikojnë në drejtim të ruajtjes së arbërishtes. Kjo dikotomi luan një rol negativ, sidomos në Kalabri, ku mësimin e shqipes e vështrojne si tradhti kundrejt arbërishtes …




*Në mesin e qendrave europiane ku studiohet gjuha dhe letërsia shqipe, Italia paraqitet në nivel të lartë edhe për organizimin e kurseve, seminareve, konferencave dhe tryezave me qëllim të prezantimit dhe shkëmbimit të njohurive, për letërsinë dhe gjuhën shqipe në kontekstin ballkanik dhe më gjerë. Duke qenë se ju keni bërë studime në këtë kontekst, si e vlerësoni pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë dhe sa janë aktiv për këto tema studiuesit e huaj?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Studiuesit e huaj kanë qenë gjithnjë të mirëseardhur në katedrat e gjuhë shqipe në Itali, sidomos me rastin e konferencave shkencore, seminareve dhe shkëmbimeve në mes dijetarësh. Katedrat, ndonëse nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në ruajtjen e gjuhës, megjithatë kanë një rol të pazëvendësueshëm në rrahjen e temave lidhur me gjuhën, historinë, me demoetnoantropologjinë, me letërsinë, me religjionin, kështu që këto tema ushqejnë kulturën arbëreshe dhe ndikojnë mbi ruajtjen e identitetit etnik. Kohët e fundit, me hapjen e Shqipërisë, katedrat janë pasuruar me studiues shqiptarë, qoftë si lektorë, qoftë si docentë, gjë që ka mundësuar njohjen dhe aplikimin e rregullave drejtshkrimore edhe të gjuhës standarde.

*Në dhjetëra publikime tuaja shkencore keni trajtuar tema të ndryshme për gjuhën shqipe, në raport me fusha të tjera. Në disa nga publikimet, gjithashtu me kujdes të veçantë keni trajtuar origjinën dhe historinë e kolonisë arbëreshe në Itali, si mund të përkufizohet pozicionimi dhe mbijetesa e këtij komuniteti përgjatë shekujve?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Pozita ekonomike shoqërore e Arbëreshëve, që nga fillimi i ardhjes së tyre në Itali, ishte tema që zhvillova në një nga Seminaret verore në Prishtinë. Arbëreshet e kolonive, përkundrazi parisë që u strehua te oborret e homologëve italianë, vazhduan të kishin qefalitë e tyre dhe një numër adekuat priftërinjsh që përbënin ajkën kulturore. Kështu, atje ku ata u vendosën, arritën të nënshkruajnë kontrakte me pronarët feudalë ku ndaloheshin angaritë tipike të kohës, ruhej tradita kishtare ortodokse, e lidhur me Papatin, ushtrohej njëfarë vetëqeverisje që parashikonte zgjedhjen e zyrtarëve vetëm nga radhët e personave arbëreshë. Ky aset lindi me Aragonezët, vazhdoi me Spanjollët dhe mbaroi me Burbonët. Ç'është e vërteta, me shkarkimin e sistemit feudal, 1812, dhe lindjen e Komunave, 1817/18, situata ndryshoi rrënjësisht dhe arbëreshët humbën privilegjet e mëparshëm duke u barazuar me qytetarët e tjerë italianë. Sa themi këtu, vlen sidomos për Arbëreshët e Sicilisë, të strehuar në çifligje kishtare, kurse në Kalabri e gjetkë pozita në shumicën e rasteve ishte e mjerueshme ngase vareshin nga feudalë të egër. Këtu del ndryshimi midis dy komuniteteve ku, ata të Kalabrisë kërkojnë ta mbajnë të fshehur identitetin arbëresh, kurse ata të Sicilisë mburren me të qenit arbëresh dhe litinjtë përreth i vlerësojnë si njesira me dy gjuhë!

*Është për t`u admiruar mbijetesa dhe ruajtja e shqipes brenda kufijve italian, madje edhe zyrtarizimi i saj si gjuhë administrative, shkollore, kulturore dhe shkencore. Sigurisht, që për këtë arritje është dashur sakrificë, mund e shumë punë. Si është arritur, sa janë tolerante ligjet italiane, karshi përdorimit të gjuhëve të huaja?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Situata, mjerisht, nuk është ashtu e volitshme si ju e përshkruani! Arbëreshët ishin dhe mbeten analfabetë në gjuhën e tyre. Italia nuk ka asnjë faj lidhur me këtë gjendje. Barazuar si nënshetas italianë, arbërshët, si edhe pakicat e tjera gjuhësore, gëzojnë me ligje shtetërore e krahinore të drejtën për ruajtjen e gjuhës dhe zhvillimin e zakoneve, por arbëreshi përton vetë, nuk di t'i shfrytëzojë mundësitë dhe hapësirat e krijuara, nuk ka lider që t'u japin një drejtim, një rrugë. Me një fjalë, në shumë vendbanime ato ligje nuk aplikonen dhe faji nuk i bie assesi shtetit italian.

*Jeni i licensuar për përkthime nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, sa sfidues është për ju ky proces, në veçanti kur kemi të bëjmë me përkthimin e teksteve letrare?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Për shkaqe shëndëtesore nuk kam mbaruar ende përkthimin e një autori nga Kosova. Është një vepër e datuar, ku rregullat drejtshkrimore nuk janë ende stabile, por argumenti më intereson si roman historik që jep një pamje të mjerisë, ku ishte katandisur populli shqiptar gjatë sundimit otoman. Mu për këtë më vjen shumë keq, si arbëresh, të shoh ripërtëritjen e ndjenjave dumbabiste në Kosovë. Një krahinë dhe sot një shtet, të cilin e dua jashtë mase dhe këtë lidhje e dëshmoj me poezitë e mia te përmbledhja "Vule uji".

*Nga aktivitetet tuaja të shumta kulturore, qysh herët keni qenë pjesë e organizimit "Ditët e Kulturës Kosovare në Siçili", sa është e njohur kultura e shqiptarëve të Kosovës ndër arbëreshë, pse duhet të trajtohet si një ligjërim i veçantë nga kultura shqiptare në përgjithësi?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Për herë të parë, 1979, kultura shqiptare e Kosovës u paraqit në kryeqendrën e Sicilisë me Ekspozitën e librit "Shqiptarë në Jugosllavi". Ekspozita, me libër nga shtëpia botuese "Rilindja" dhe nga "Enti i librit shkollor", u mbajt te Liceu, ku isha profesor dhe zgjati disa ditë, kështu që arbëreshët patën rastin të njiheshin me Kosovën dhe me prodhimet e botuara në gjuhën shqipe. Por kulmi i njohjes së ndërsjellë Kosovë / Arbëreshë ishin Ditët e Kulturës Kosovare në Sicili, 1980, ku mbi njëqind intelektualë nga Kosova morën pjesë: Profesorë nga universiteti, Ansambli "Shota", poetë e shkrimtarë, teatri krahinor, ekspozita e piktorëve, filmi kosovar. Hapja e Ditëve u bë zyrtarisht në Selinë e Krahinës Siciliane, kurse programi, përveçse në qytet, u zhvillua nëpër të pesë horet/vendbanimet arbëreshe. Për t'u përgjegjur pyetjes suaj, duhet nënvizuar se kultura kosovare ka shumë gjasa me arbëreshen. Që të dyja janë kultura minoritare brenda shtetit ku kanë jetuar. Megjithatë për arbëreshët ka qenë një surprizë jo vetëm prania e një popullate shqiptare aq të madhe në një shtet tjetër, por trajtimi i saj i keq në një shtet që pretendonte të ishte federativ.

*Disa herë, keni qenë pjesë e Seminarit Ndërkombatar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, si e vlerësoni këtë përvojë tuajën në Kosovë?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Seminari ka luajtur dhe lot një rol ndërkombëtar për gjuhën dhe kulturën shqiptare. Jo rastësisht, çështja e Kosovës u bë e njohur me anë të pjesëmarrjes në të nga ana e studiuesve prej shumë vendesh të rruzullit. Për arbëreshët dhe për mua personalisht, ky seminar i përvitshëm, ka qenë ujë për gojën e shkrumet.

*Sa është e njohur gjuha shqipe në pjesët e Italisë të pabanuara me arbëreshë?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Mësimi i shqipes, meqë jepet në nivelin universitar, ndiqet më së shumti nga studentë italianë kundrejt arbëreshëve. Nga këtu na del se njohja e kulturës shqiptare nuk është e huaj në truallin italian.

*Sa është e njohur letërsia shqipe nga lexuesi Italian dhe cilët janë autorët e preferuar?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Pa dyshim se autori me i përkthyer (nga frëngjishtja!) dhe me i njohur ishte Kadareja, por kohët e fundit janë bërë të përhapur autorë më të rinj. Shumë kanë lexuar "Vergine giurata", mbi fenomenin shqiptar e burreneshës …

*A mund të na thoni çfarë jeni duke punuar momentalisht në fushën e albanologjisë dhe filologjisë?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** Jashtë filologjisë me të cilën nuk merrem drejtpërsedrejti, kisha përgatitur një studim mbi kultin e shenjtorëve Flori dhe Lauri, të cilin do ta kisha paraqitur në Seminarin e sivjetshëm në Prishtinë. Përmbajtja e studimit rrjedh nga kureshtja sesi kulti i tyre mbërriti në Sicili dhe si dy portrete me mozaik u janë kushtuar atyre te kisha e Gjergjit nga Antiokia, sh. XII, kishë kjo që sot është bërë famulli për arbëreshët e Palermos.

*Kur ishit fëmijë, a flisnit shqip në familje dhe në lagje?*

**Giuseppe A. (Zef) Chiarmonte:** S'kishim gjuhë tejtër në familje dhe në hore/qytezë. Asokohe italishtja ime dhe e shokëvet të mi ishte vetëm një perkthim nga arbërishtja, megjithë ngatërresat që kjo shpesh na sillte me joarbëreshët!

*/KultPlus.com/*

E rrallë

## Lakuriqët “pushtojnë” një qytet të Australisë



Një numër i madh i lakuriqëve ka zbritur në një qytet të vogël në Australi, duke shkaktuar shkatërrim për banorët vendës. Qyteti është i “pushtuar” nga lakuriqët, që ndonjëherë duken si “dhelpra fluturuese” në qytetin Ingham të Queenslandit. “Është si një tornado e lakuriqëve mbi qytet”, ka thënë banori Adam Kaurila.

FOTO E DITES



Një blerëse në Hong Kong, e veshur me një maskë mbrojtëse, shihet me karrocën e saj të blerjes në një dyqan me rafte të zbrazura. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Vajza e vogël shndërrohet në gur

Një vajzë e re po përballet me ‘ferrin e gjallë’ për shkak të një çrregullimi të rrallë që e bën lëkurën e saj të duket si gur. Vajza shtatëvjeçare Rajeshwari, e cila jeton në shtetin indian të Chhattisgarh, vuan nga sëmundje e pashërueshme e quajtur ikitozë, e cila bën që lëkura e saj të bëhet me luspa. Ato kanë mbuluar krahët, këmbët dhe pjesën më të madhe



të shpinës, duke ia bërë më të vështirë ecjen apo edhe uljen.

BARSOLETA E DITËS



**Një qytetar shkon te mjeku për t’u kontrolluar:**
**- Pini duhan?**
**- Po, pi.**
**- Pse pini?! A e dini që duhani dalëngadalë ju vret?**
**- Ani de, se edhe unë kurrgjë për ngut s’e kam.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00**

## Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno







**Në ora 18:00**

## Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser’Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

**Çdo natë në ora 20:00**

## STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams







**Çdo natë në ora 22:30**

## THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
**Shkoni përpara në rrugën që keni marrë, edhe nëse ndonjëherë dyshoni se nuk është me të vërtetë e drejtë.**



**DEMI**
**Nëse po udhëtoni, përpiquni ta jetoni me një frymë ndryshe nga zakonisht. Mbajtja e një libri logjik mund të jetë një ide më e rëndësishme sesa duket.**



**BINJAKËT**
**Mos e forconi veten tuaj në një çështje të ndjeshme sepse mund të zhgënjeheni ose të humbni kohë dhe para.**



**GAFORRJA**
**Kini kujdes sepse ky angazhim i vazhdueshëm mund t’ju lodhë më shumë sesa që duhet dhe ju largon nga gjërat e rëndësishme në jetë.**



**LUANI**
**Në fushën sentimentale grindjet me partnerin bëhen edhe më të mëdha duke kërcënuar në horizont.**



**VIRGJËRESHA**
**Do të kini ide të shkëlqyera, do të vendosni taktika të mira biznesi dhe do të kontaktoni njerëz interesantë.**



**PESHORJA**
**Do të ndiheni i hutuar. Gjendja është më pak me diell se zakonisht sot. Për të qenë të lumtur ju duhet ngrohtësi përreth jush.**



**AKREPI**
**Do të keni takime midis miqve. Mund të merreni me sporte apo udhëtime. Mendje dhe zemër e qetë dhe me plot pritshmëri.**



**SHIGJETARI**
**Nëse shpesh mendoni për një punë të lënë të pazgjidhur, por që duhet të zgjidhet absolutisht, sot është dita e duhur për ta mbyllur atë përfundimisht.**



**BRICJAPI**
**Do të keni disa kundërvajtje të vogla dhe çaste zemërimi, por nuk është nevoja që ta bëni situatën më të vështirë.**



**UJORI**
**Ekziston mundësia për të marrë një ofertë që është në përputhje me aftësitë tuaja dhe idetë interesante ekonomikisht.**



**PESHQIT**
**Do të kaloni çaste të paharrueshme me partnerin tuaj që do të jetë i gatshëm t’ju përkëdhelë dhe do të plotësojë çdo dëshirë tuajën.**

# Pak ditë pas humbjes tragjike, bashkëshortja dedikim prekës për Kobe Bryantin



20 ditë pas humbjes së vajzës dhe bashkëshortit, Vanessa Bryant ka ndarë dhimbjen me ndjekësit në rrjetin social "Instagram". Ajo ka postuar një fotografi të bijës së saj të shkëputur nga një prej homazheve që shoqet e klasës kishin bërë për të. "Gianna ime. Zot sa më mungon! Kam qenë shumë me fat të zgjohesha çdo ditë duke parë fytyrën tënde të bukur për 13 vjet me radhë. Do të doja ta bëja këtë deri në frymën time të fundit. Mami të do shumë!", ka shkruar Vanessa.

Ky postim erdhi disa orë më vonë atij dedikuar të shoqit. "Shoku im më i mirë! Më ka marrë malli të të dëgjoj të më thuash: Mirëmëngjesi princeshë".

Kobe Bryant, 41-vjeçar, vajza e tij Gianna 13-vjeçare dhe shtatë persona të tjerë humbën jetën më 26 janar si pasojë e një aksidenti ajror.

# Zendaya dhe Jacob Elordi janë në lidhje të dashurisë



Aktorët e njohur Zendaya dhe Jacob Elordi të hënën e konfirmuan lidhjen e tyre të dashurisë. Ata rrugëve të Nju Jorkut janë fotografuar nga paparacët gjersa putheshin. Çifti duket shumë i lumtur nën shoqërimin e njëri-tjetrit.



# Ronaldo mahnitet nga kërcimi i Georginës me balerinët në Sanremo

Partnerja e Cristiano Ronaldos, Georgina, ka marrë pjesë në festivalin e Sanremos. Ajo ka surprizuar publikun duke kërcyer një tango në skenë së bashku me një grup tjetër balerinësh. Me një fustan të zi, flokët e kapura dhe tepër sensuale, ajo jo vetëm që mahniti publikun, por edhe Ronaldon i cili ishte duke e parë gjithë kohës me shumë adhurim dhe dashuri. Pasi përfundoi kërcimin, bukuroshja u shpreh se ishte hera e parë që kërcente një tango dhe se Cristiano e kishte ndihmuar shumë për ta përgatitur.

# Anne Marie publikon këngën më të re



Këngëtarja e njohur Anne Marie ka publikuar këngën më të re. Kjo këngë quhet "Birthday", e cila brenda pak orëve të publikimit ka marrë mijëra klikime në kanalin "Youtube".




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Në kërkim të gjysmëfinales së Kupës

**Gjysmëfinalja e Digitalb Kupës është synimi i disa prej klubeve të Kosovës. Drenica, pavarësisht se ka një kundërshtar të fortë, po synon të kualifikohet tutje. Të njëjtin synim e ka edhe Ballkani që përballet të dielën me Dukagjinin. Ndërkaq, Prishtina është e mobilizuar për ta kaluar në këtë rreth Vushtrrinë**

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 SHKURT - Sezoni pranveror fillon sot (e shtunë) me ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës, kurse disa prej klubeve kanë shpalosur ambiciet në këtë garë. Skuadra e Drenicës, e cila ka bërë shumë ndryshime gjatë pushimit dimëror, përfshirë edhe shtabin teknik, synon që të arrijë sukses ndaj Gjilanit në ndeshjen që zhvillohet sot nga ora 12:30 në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj.

Qemail Elshani ka thënë për gazetë se Drenica ka ambicie të mëdha ani pse kundërshtar ka një skuadër shumë cilësore. "Gjilani ka njërën ndër skuadrat më të forta në ligën tonë. Ekziston një superorganizim nga ana jonë. Do ta japim maksimumin që të ecim tutje në Kupë sepse, siç thashë, kemi disa ambicie. Një prej tyre është Kupa e Kosovës", ka thënë Elshani.

Të shtunën zhvillohet edhe ndeshja tjetër çerekfinale në mes të Prishtinës dhe Vushtrrisë. Për këtë ndeshje ka folur sulmuesi Ahmed Januzi, i cili ka bërë me dije se Prishtina të gjithë kundërshtarët i respekton njëjtë, por në këtë ndeshje synon fitoren dhe kualifikimin tutje. "Pavarësisht se a është Vushtrria apo ndonjë skuadër tjetër, nuk na intereson shumë se me kë ndeshemi. E respektojmë kundërshtarin, por ne kemi prioritetin tonë kalimin në gjysmëfinale. Si ndeshje e parë e stinorit, normalisht se na jep avantazh që luajmë në fushën tonë dhe vetëbesim edhe për fillimin e kampionatit pas një jave. Fatmirësisht, nuk kemi pasur lëndime, stërvitjet kanë ecur mirë dhe mezi presim fillimin e ndeshjes", ka thënë Januzi për faqen e klubit.

Të dielën, Ballkani, që është kampion vjeshtor, i shkon skuadrës së Dukagjinit në Klinë. Liridon Fetahaj për "Epokën e re" ka deklaruar se synim është gjysmëfinalja. "Mendoj se skuadra e Dukagjinit është shumë më e fortë se në vjeshtë dhe renditja e saj në tabelë nuk tregon realitetin, prandaj nuk do të jetë aspak lehtë ndaj saj. Ne jemi të përgatitur maksimalisht dhe me një angazhim nga të gjithë lojtarët shkojmë në Klinë për të fituar dhe për t'u kualifikuar në gjysmëfinale", ka thënë Fetahaj.

**ÇEREKFINALJA E DIGITALB KUPËS**

**Të shtunën takohen:**
12:30 Drenica - Gjilani
13:00 Prishtina - Vushtrria

**Të dielën takohen:**
12:30 Dukagjini - Ballkani

**Të mërkurën takohen:**
12:30 Liria - Feronikeli



### Feronikeli me fitore e mbylli fazën përgatitore në Turqi

FC Feronikeli e ka fituar takimin miqësor ndaj skuadrës Rukh Brest me rezultat 2-0. Takimi ndaj Rukh Brest ishte miqësorja e fundit për sa i përket kësaj faze përgatitore të ekipit nga Drenasi, që u mbajt në Antalia të Turqisë. Feronikeli e kontrolloi takimin miqësor gjatë gjithë ndeshjes dhe kishte dukshëm më shumë raste se kundërshtarët. Besmir Bojku në pjesën e parë e shënoi golin e parë për "Niklin", kurse goli i dytë ishte autogol. Skuadra e FC Feronikelit të dielën, më datë 09 shkurt, rikthehet në Kosovë.

# Rexha: Kupa do të mbetet në Rahovec




RAHOVEC, 7 SHKURT - Në qytetin e Rahovecit do të organizohet "Osa Termosistem Final 8". Tetë skuadra do të garojnë për trofeun e çmuar dhe priten ndeshje shumë interesante që nga dita e parë më 11 shkurt deri më 15 shkurt, kur do të jenë finalet në konkurrencën e meshkujve dhe femrave. Një nga skuadrat që e synon Kupën është Rahoveci. Kapiteni i kësaj skuadre, Bardh Rexha, beson se Kupa do të mbetet në Rahovec. "I jemi falënderues Federatës së Basketbollit të Kosovës që na ka besuar sërish organizimin e Kupës në Rahovec. Ne jemi duke u përgatitur maksimalisht, pasi jemi edhe organizatorë dhe besoj se Kupa do të mbetet në Rahovec. Ne jemi përgatitur maksimalisht për garat e Kupës, një trofe shumë i rëndësishëm për ne", është shprehur Rexha për faqen zyrtare të FBK-së.

Rahoveci në çerekfinale do të ndeshet me Trepçën. Rahoveci është lider i renditjes, kurse në edicionin e kaluar ishte në finale të Kupës dhe "play-off"-it.

## Azemi: Synojmë trofeun e Kupës

PRISHTINË, 7 SHKURT - Fituese e fundit e Kupës është Sigal Prishtina. Kapiteni legjendar i kësaj skuadre, Edmond Azemi, e dëshiron edhe një trofe të çmuar në karrierën e tij. "Synimi ynë është ta fitojmë trofeun e çmuar. Nuk do ta kemi aspak lehtë për shkak se edhe skuadrat e tjera janë shumë të forta. Takimin e parë e kemi ndaj Golden Eagle Yllit, që nuk është lehtë. Ne jemi përgatitur për garat e Kupës dhe trofe. Udhëtojmë me synime për të fituar. Shpresoj se do t'ia arrijmë qëllimit në fund", është shprehur Azemi për faqen zyrtare të FBK-së. Sfida e parë për Sigal Prishtinën është ndeshja çerekfinale me Golden Eagle Yllin që në stinorin pranveror nuk ka pësuar asnjë humbje në Superligë.



## Hamann, Bayernit: Transferojeni Rashicën, jo Sanen

MUNCHEN, 7 SHKURT - Legjenda e futbollit gjerman, Dieter Hamann, ka këshilluar Bayern Munichut që ta transferojë yllin e Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica. "Bavarezët" prej kohësh janë të lidhur me anësorin e Manchester Cityt, Leroy Sane, i cili nuk ka fshehur dëshirën për të kaluar te kampionët e Bundesligës. Por, sipas Hamann, që gjatë karrierës së tij ka veshur fanellën e Liverpoolit dhe Bayern Munichut, këta të fundit do të bënin mirë nëse shikojnë mundësinë e transferimit të Milot Rashicës, lojtarit që po mban i vetëm mbi supe Werder Bremenin. "Nëse do të isha te Bayerni do të shkoja për Rashicën në vend të Sanes. Të marrësh një futbollist për 100 milionë pa pasur siguri. Do të shkoja për Rashicën, i cili me siguri do të ishte një opsion shumë më i lirë", ka deklaruar Hamann.



# Dumoshi: Ky vit do të jetë viti i Olimpiadës

Prishtinë, 7 shkurt - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në takim kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, me të cilin kanë diskutuar për planet dhe bashkëpunimin në mes të MKRS-së dhe KOK-ut me qëllim të ngritjes së sportit në përgjithësi. Me këtë rast, ministrja Dumoshi shprehi gatishmërinë për përkrahjen e vazhdueshme të KOK-ut, me synimin që mbështetja të rritet vit pas viti në mënyrë që të arrihen sa më shumë suksese në fushën e sportit vendor. "Ky vit do të jetë viti i olimpiadës, sepse Kosova në Lojërat Olimpike do të përfaqësohet me shumë sportistë", ka thënë Dumoshi. Ndërkaq kryetari i KOK-ut, Besim Hasani, uroi ministren Dumoshi për marrjen e detyrës së re dhe e falënderoi për gatishmërinë që shprehu ajo për ta mbështetur edhe më tej Komitetin Olimpik të Kosovës. Gjithashtu, ai njoftoi ministren Dumoshi për proceset nëpër të cilat po kalon KOK-u. Ata u pajtuan që sporti edhe më tutje të jetë prioritet i MKRS-së, me fokus të veçantë në investimet kapitale në infrastrukturë, masivizimin e sportit, ngritjen e cilësisë dhe nxjerrjen e talenteve të reja.



# Westbrooki, vendimtar në fitoren e Houstonit

LOS ANXHELOS, 7 SHKURT - Falë 41 pikëve të Russell Westbrookut, skuadra e Houstonit fitoi me rezultat 121-111 ndaj Lakersave. Një ndeshje spektakolare dhe me shumë emocione, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Për Westbrookun kjo ishte një mbrëmje magjike (arriti kuotën e 20 mijë pikëve në NBA), më i miri në fushë për teksanët, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Davisit dhe 18 të LeBron Jamesit. Pa probleme ka fituar skuadra e Milwaukees, ekipi me rekordin më të mirë në NBA (44 tore e 7 humbje), duke mundur 112-101 Philadelphian. Fitorja e vendësve u vendos në pjesën e dytë, me Antetokounmpo që realizoi 36 pikë e 20 rebounde. Në ndeshjet e tjera, skuadra e Portlandit fitoi 125-117 ndaj San Antonios, takim ku u dalluan Lillardi me 26 pikë e 10 asistime si dhe veterani Carmelo Anthony, autor i 20 pikëve. Fitore në minutën e fundit korri skuadra e New Yorkut, që mposhti 103-103 Orlandon (Randle 22 pikë), ndërsa New Orleansi fitoi 125-119 ndaj Chicagos, me Williamsonin autor i 21 pikëve.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| New York - Orlando | 105-103 |
| New York - Orlando | 105-103 |
| Chicago - New Orleans | 119-125 |
| Milwaukee - Philadelphia | 112-101 |
| Portland - San Antonio | 125-117 |
| Lakers - Houston | 111-121 |

## SHKURT

### Politano i lumtur te Napoli, synon Evropianin me Italinë

Mateo Politano iu bashkua Napolit në muajin janar dhe debutoi menjëherë në sfidën që të kaltrit e fituan me rezultat të thellë ndaj Sampdorias. Sulmuesi italian është shfaqur mjaft i lumtur për faktin që iu bashkua napolitanëve, ndërsa foli edhe për punën me trajnerin Genaro Gattuso dhe objektivat personale për këtë sezon. "Jam shumë i lumtur që iu bashkova Napolit. Mendoj se skema 4-3-3 është ajo që më përshtatet më shumë, ndaj dua që të ndihmoj skuadrën dhe të arrij një vend në Kampionatin Evropian. Me Gattuson punojmë shumë me topin dhe kjo më pëlqen shumë, ndërsa me Conten përqendroheshim shumë tek aspekti fizik", u shpreh Politano.

### Pulevi dëshiron përballje me Joshuan

Kubrat Pulev po tenton që përmes promotorit të tij, Bob Arum, ta zhvillojë një meç me kampionin e botës në boks, Anthony Joshua. Edhe pse oferta ende nuk është pranuar nga anglezi, Pulev tashmë ka bërë paralajmërim për Joshuan. Ish-kampioni i dyfishtë evropian në boks i ka bërë me dije Anthony Joshuas, duke i thënë se do ta mposhtë në Londër. "Qetësohu kampion, e di që e ke të vështirë të ndeshesh jashtë vendit tënd dhe ke plotësisht të drejtë për këtë", u shpreh 38-vjeçari. Ende nuk ka diçka zyrtare për detajet e zhvillimit të kësaj lufte, por më shumë mundësi do të zhvillohet në Londër, saktësisht në stadiumin e ri të Tottenhamit, "Totteham Hotspur's Stadium". Pulev në 29 meçe të zhvilluara ka arritur t'i fitojë 28 prej tyre. Humbja e tij e fundit ishte ajo kundër Vladimir Klitschkos.

### Arsenali e sheh shpëtimin te Wengeri

Arsenali po kalon një sezon të vështirë. Larg çdo objektivi dhe e zhytur në rekorde negative, skuadra londineze duhet të përballet edhe me kritikat e tifozëve. Në shënjestër të tyre kanë përfunduar disa prej lojtarëve më të rëndësishëm të skuadrës. Në fillim Xhaka, tash edhe Aubameyang po sulmohen hapur. Nuk bënë punë as ndryshimet në pankinë, me largimet e Unai Emery dhe Frederic Ljumberg. As Mikel Arteta nuk po arrin ta kthejë sezonin e "Topçinjve". Për këtë arsye, drejtuesit e klubit po mendojnë për një rikthim të madh. Bëhet fjalë për Arsene Wenger. Francezi që qëndroi për më shumë se 22 vjet në bankinën e Arsenalit shihet si njeriu i duhur për ta kthyer skuadrën në shina. Nuk bëhet fjalë për bankinën, por për një detyrë shumë aktive si një siguri për tifozët se ekipi do ta kalojë krizën. Ofertat janë në tavolinën e ishtrajnerit, i cili ka kohë të kthejë një përgjigje përfundimtare.

### Platini: Gjithmonë isha kundër VAR-it

Ish-presidenti i UEFA-s, Michel Platini, është akoma kundër VAR-it, duke deklaruar se ai ishte kundër që nga dita e parë pasi, sipas tij, futbolli nuk mund të gjykohet me video. Platini ka dhënë një intervistë për "Il Corriere dello Sport" për një numër çështjesh dhe u pyet për mendimin e tij për VAR-in, i cili ka tërhequr kritikat në të gjithë Evropën. "Unë e thashë atë që nga dita e parë, nuk e mbaja me vete, unë deklarova kundërshtimin tim ndaj teknologjisë, veçanërisht nëse përdoret në këtë mënyrë", ka thënë fillimisht Platini, duke shtuar: "Futbolli nuk mund të gjykohet me video. Televizioni shtrembëron tërë perceptimin e incidenteve individuale. Futbolli është një sport kontakti, ka ndërhyrje të rregullta, të cilat, nëse kalohen përmes filtrit të TV-së dhe ngadalësohen, çojnë në interpretime të papranueshme. Një faull duhet të vlerësohet dhe gjykohet në kohë reale. VAR-i gjithashtu vret eksitimin e golit, ai e detyron lojtarin ta festojë atë pesë minuta më vonë dhe, ndonjëherë, edhe dy herë". "Për një lojë më të barabartë, VAR-i nuk është i nevojshëm, por gjyqtarë më të mirë. Polemika e teknologjisë nuk kufizohet vetëm në Itali, por edhe në Angli, Spanjë dhe Gjermani", ka deklaruar Platini.

**Ključne odgovornosti:** Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na osnovu profesionalnog nivoa uljudnosti, brige i poštovanja prema pacijentu i radnom osoblju.

**Opis rada i odgovorne delatnosti:** Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada, obezbedi visok standard nege pacijenata, Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi, Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno, Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju, Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta, Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi, Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete, Vrši nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja, Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju, Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.

**Neophodne kualifikacije: Zavrsena specializacija iz odredjene oblasti**

**Potrebna dokumentacija:**

1. Diploma medicinskog fakulteta – (origjinal ili overena kopija)
2. Uverenje o specializacija - (origjinal ili overena kopija)
3. Validna licenca rada od Ministrarstva Zdravlja(origjinal ili overena kopija )
4. Izvod iz maticne knjige rodjenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
5. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom(originalu ili overena kopija).
6. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos)

**Radno mesto br. 4. Bachelor fizioterapeuta**

**Glavna svrha radnog:** Pružanje usluga zdravstvene zaštite na sekundarnom nivou.

**Opis rada i odgovorne delatnosti:** Pruža i vodi Fizioterapeutske usluge pacientima, uključujuči rocenivanje, lečenje, planiranje I realizaciju tretmana i vodjenje neophodne dokumentacije, Pruza fizioterapeutske usluge pacientima, Izvodi procenivanje pacienata kako bi utvrdio potrebu za intervenciju / tretman, Procenuje pacienta kao bih dobio potrebne informacije za planiranje i realizaciju fizioteraeutskog tretmana, Iizvodi specificne procene na osnovu indikacija iinteyrpretira i komunicira nalaze ovih procena, Razradjuje plan tretmana na osnovu identifikovanih problema, kao i odredjuje ciljeve lećenja, Izvodi postupke predvidjene u plan lecenja, Modificira i adaptira tretman na osnovu indikacija za postizanje ciljeva, Dokumentira rezultate procene, tretmana, pracenja i zavrsetka tretmana, Preporucuje uzimanje i izradu ortotickih i ptotetickih pomagala kao i daje savete pacientima, porodici i drugom osoblju za upotrebu ovih pomogala, Nadgleda i vodi posao fizioterapeutskih teknicara i drugog pomocnog osoblja u implementiranju plana tretmana, Nadgleda studente i volutere, Komunicira na formalan i ne formalan nacin sa ostalim strucnjcima oko spovodjenja rehabilitacionog programa, Preuzima odgovornost za kontinuirano profesionalno usavrsavanje i unapredjenje, Raportira i odgovara glavnom fizioterapeutu Jedinice.

Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.

**Neophodne kualifikacije: Zavrsenu fakukultet fizioterapije Bachellor**

**Potrebna dokumentacija:**

1. Diploma fakulteta Bachelor fizioterapije– (origjinal ili overena kopija)
2. Validna licenca rada od Ministrarstva Zdravlja(origjinal ili overena kopija )
3. Izvod iz maticne knjige rodjenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
4. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom(originalu ili overena kopija).
5. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos)

**Uslovi za prijem u rekrutaciju za sve pozicije:** Pravo na rekrutaciju imaju svi drzavljani Republike Kosova koji su zavrsili adekuatnu spremu za radno mesto za koje konkurisu.

Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim medijima.

Aplikacije se dobijaju u administraciji bolnice. Prijava sa pratećom dokumentacijom se podnosi Upravi bolnice u Prizrenu, ulica "Sheh Emini" str. svakog radnog dana od 12:00 do 14:00. Prijave podnesene nakon isteka roka nisu prihvaćene, dok su nepotpune prijave odbijene.

Hastane Tüzüğü'nün 13. maddesi, 1.1 no.lu maddesi uyarınca, 03/L-212 sayılı Çalışma Kanununun 8. maddesine dayanarak, HKÜH'nun konkur islemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin, HKUK Genel Müdürü Dr.Basri Sejdiu tarafından 18.06.2019 tarihinde onaylanan 13.06.2019 tarihli ve 02/132 sayılı İşe alım talebi uzerine, Genel Hastane Yönetim Kurulu şunu ilan eder

**KAMUSAL İŞ İLÂNI**

Süresiz olarak işe kabul edilmek için

**Gorev unvani:**

1. **Uzman cerrah doktoru (2 konum)**
   Maaş oranı: 8.4
   Çalışma oranı: tam zamanlı
   Sözleşme Süresi: Süresiz olarak 3 (üç) aylık deneme süresi ile
2. **Uzman cocuk doktoru (2 konum)**
   Maaş oranı: 8.4
   Çalışma oranı: tam zamanlı
   Sözleşme Süresi: Süresiz olarak 3 (üç) aylık deneme süresi ile
3. **Uzman göz doktoru (1 konum)**
   Maaş oranı: 8.4
   Çalışma oranı: tam zamanlı
   Sözleşme Süresi: Süresiz olarak 3 (üç) aylık deneme süresi ile
4. **Lisansli Fizyoterapist ( 1 konum)**
   Maaş oranı: 8.4
   Çalışma oranı: tam zamanlı
   Sözleşme Süresi: Süresiz olarak 3 (üç) aylık deneme süresi ile

**Referans numarasi: 8/5, data 07.02.2020**

**İşyeri: 1, 2, 3 - Uzman cerrah, çocuk doktoru, göz doktoru**

**İşyerinin temel amacı:** Ikincil sağlık hizmetlerinin sağlanması.

**Temel sorumluluklar:** Sağlık hizmetlerinin, profesyonel nezaket seviyesine dayanan niteliksel ve niceliksel bir şekilde sunulması, hasta ve çalışan personele özen ve saygı gösterilmesi.

**Görev Tanımı ve Sorumluluk Alanları:** Bölüm Başkanı ve diğer yönetim kadrosu ile birlikte ait olduğu insan kaynakları, ekipman, tesisler ve envanteri yönetir, Yüksek standartta hasta bakımı, Nezaket, hasta ve personel bakımı ve saygısı, Nezaket ve profesyonel işbirliği sağlar diğer personel ile, Hastanın kabulü, muayenesi ve uygun tedavisi, Tıbbi dokümantasyon (hastalık öyküsü, broşür, protokol, vb.) aracılığıyla düzenli kayıt yapar, Sağlık kuruluşuna kabul edilen hastalara düzenli ziyaretler yapar, Ziyaret talep eder Denetleyici-danışmanlık, Personelin günlük iş görevlerini denetler, Gerçekleştirilen iş hakkında profesyonel görüş verir, Denetim otoritesinin çalıştığı kurumdaki işin ilerlemesi için gerekli diğer görevleri yapar, yorganın mesleği ile bağlantılı olarak gerekli Bireysel ve kolektif çalışmalarının müfredatını işyerinde hazırlamaktan sorumludur. Çalışanları günlük iş görevlerinin gerçekleştirilmesinde görevlendirir, Mesleki eğitim programları ve kursları sağlar ve geliştirir, Düzenli muayene yapar (işyerinde tesis, ekipman ve envanter kontrolü), Herkes için temiz ve güvenli bir ortam sağlar, Sarf malzemelerini ve diğer ekipmanları yönetir, Verimli sistem sağlar Kurum içindeki herkese iletişim kurar, Profesyonel hasta tedavi protokollerini inceler ve uygular, Profesyonel bilimsel araştırma çalışmalarına katılır, Ünitede (birim) mesleki ve toplu eğitimin yönetim niteliklerini geliştirmek için önlemler alır, Yeterliliğe dayalı ek görevler yapar Mesleki ve yönetim vb. Mesleki düzeyine dayalı sağlık hizmetlerinin kalitatif olarak sunulması, Hasta tedavisi ile ilgili yazılı ve sözlü mesleki tavsiye verilmesi ve günlük tedavinin reçetelendirilmesi, Klinik-laboratuvar muayenelerinin düzenini ve planını belirler, Ambulansta çalışıyor ayakta tedavi ve muayene-kabul işlemlerini gerçekleştirir, diğer görevleri gerektiği gibi yerine getirir.

**İş için gerekli nitelikler 1,2,3: İlgili alanda tamamlanan uzmanlık**

**Gerekli belgeler**

1. Tip fakultesi diplomasi - (orjinal veya onayli kopya)
2. Uzmanlık belgesi - (orjinal veya onayli kopya)
3. Sağlık bakanlığı tarafından verilen çalışma izni (orjinal veya onayli kopya)
4. Doğum belgesi (orjinal veya onayli kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
5. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onayli kopya)
6. Sağlık durumu raporu (ise alindiktan sonra)

**İşyeri 4nr: Lisansli Fizyoterapist**

**İşyerinin temel amacı:** Ikincil sağlık hizmetlerinin sağlanması.

**İş Tanımı ve Fizyoterapistler İçin Sorumluluk Alanları:** Her zaman doğru ve güvenli hasta bakımı sağlamak, hastalara fizyoterapi hizmetleri sunmak ve yönlendirmek, değerlendirme, eğitim, tedavi planlaması ve gerekli dokümantasyonun uygulanması ve sürdürülmesi dahil, Hastalara fizyoterapi hizmetleri sunar, Müdahale/tedavi ihtiyacını belirlemek için hasta muayeneleri yapar, Gerekli planlama bilgilerini elde etmek için hastayı değerlendirir tedavi uygular, belirtildiği şekilde spesifik değerlendirmeler yapar, değerlendirme verilerini yorumlar ve iletir, Belirlenen problemlere göre tedavi planı geliştirir ve tedavi hedeflerini belirler, Tedavi planında öngörüldüğü şekilde tedaviyi uygular, Tedaviyi amaçlara ulaşmak için hedeflere göre uyarlar, Tedavi sırasında elde edilen sonuçların sürdürülmesi ve iyileştirilmesi için ev programına tavsiye ve rehberlik sağlar, Değerlendirme, tedavi, takip ve tedavinin tamamlanmasının doküman sonuçları, Ortopedik yardımların elde edilmesini ve üretilmesini önerir veya Tedavi planının uygulanmasında fizyoterapi teknisyenleri ve diğer destek personelinin çalışmalarını denetler ve yönlendirir, Diğer program koordinasyon profesyonelleri ile resmi ve gayri resmi iletişim kurar hasta rehabilitasyonu, sürekli mesleki eğitim ve mesleki gelişim sorumluluğunu üstlenir. Gerektiğinde diğer görevleri de yerine getirir.

**İş için gerekli nitelikler: Lisansli Fizyoterapist fakultesi**

**Gerekli belgeler**

1. Lisansli fizyoterapist diplomasi – (orjinal veya onayli kopya)
2. Sağlık bakanlığı tarafından verilen çalışma izni (orjinal veya onayli kopya)
3. Doğum belgesi (orjinal veya onayli kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
4. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onayli kopya)
5. Sağlık durumu raporu (ise alindiktan sonra)

**Tüm pozisyonlar için işe alım şartları:** Yeterli eğitimi tamamlamış ve başvurdukları iş başvurusunda bulunmaya uygun olan tüm Kosova Cumhuriyeti vatandaşları başvuru yapabilir.

Iş ilanı, kamusal medyada yayınlandıgı tarihten itibaren 15 gun acık kalacaktır.Başvurular Hastane Idaresinden alınmaktadır. Ekli belgelere sahip başvurular Prizren hastane idarsine, "Sheh Emini" sokagına her iş gunu 7:00-15:00 saatlerinde gonderilir. Son başvuru tarihinden sonra sunulan başvurular kabul edilmezken, eksik başvurular reddedilir.

Prizren, 07.02.2020

Drejtor i Administrates
Melinda Çollaku, Mr.sc. e juridikut

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

**Bilanci i gjendjes me : 31.12.2019** Euro'000

| | Tremujori paraprak | Tremujori vijues |
|---|---|---|
| **Pasurite** | | |
| | | |
| Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në | 5,752.39 | 10,399.26 |
| Kërkesat ndaj bankave | 1,369.67 | 1,332.33 |
| Bonot e thesarit | | |
| Investimet në letra me vlerë | 6,760.09 | 6,588.73 |
| Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve | 43,211.41 | 43,854.27 |
| Patundshmëritë dhe pajisjet | 1,100.95 | 1,054.67 |
| Pasuritë e paprekshme | 224.55 | 282.73 |
| Pasuritë tatimore të shtyra | | |
| Pasuritë tjera | 239.15 | 219.57 |
| **Gjithsej pasuritë** | **58,658.21** | **63,731.56** |
| | | |
| **Detyrimet** | | |
| | | |
| Depozitat e klientëve | 32,640.37 | 39,538.90 |
| Detyrimet ndaj bankave | 6,853.22 | 16,042.11 |
| Fondet tjera të huazuara | 11,004.47 | - |
| Detyrimet tatimore të shtyra | | |
| Detyrimet tjera | 335.74 | 331.26 |
| **Gjithsej detyrimet** | **50,833.80** | **55,912.27** |
| | | |
| **Ekuiteti i aksionarëve** | | |
| | | |
| Kapitali aksionar | 10,000.00 | 10,000.00 |
| Rezervat e kapitalit | | |
| Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake | - 2,190.79 | - 2,190.79 |
| Fitimi/(humbja) e vitit aktual | 15.20 | 10.07 |
| Përbërësit tjerë të ekuitetit | | |
| **Gjithsej ekuiteti i aksionarëve** | **7,824.40** | **7,819.28** |
| | | |
| **Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve** | **58,658.21** | **63,731.56** |

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

**Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31.12.2019** Euro'000

| | Tremujori paraprak | Tremujori vijues |
|---|---|---|
| | | |
| Të hyrat nga interesi | 1,959.00 | 2,670.93 |
| Shpenzimet e interesit | - 555.51 | - 790.94 |
| **Neto të hyrat nga interesi** | **1,403.49** | **1,880.00** |
| | | |
| Të hyrat nga tarifat dhe komisionet | 63.25 | 95.91 |
| Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve | - 110.49 | - 154.18 |
| **Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet** | **- 47.23** | **- 58.27** |
| | | |
| Neto të hyrat nga tregtimi | 4.83 | 7.71 |
| Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare | 0.12 | 0.12 |
| Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative | - 1,168.40 | - 1,608.39 |
| | | |
| **Gjithsej të hyrat** | **192.80** | **221.16** |
| | | |
| Provizionet për humbjet nga kreditë | - 177.61 | - 211.09 |
| | | |
| **Fitimi/(humbja) para tatimit** | **15.20** | **10.07** |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | - | - |
| **Fitimi/(humbja) neto** | **15.20** | **10.07** |
| | | |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse | - | - |
| | | |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse** | **15.20** | **10.07** |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice*

AAPSK

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencija za Upravljane Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

## Ftesë për Ankand Publik

**Datë 07.02.2020** **Referenca: AAPSK - 02/2020**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Sasia/copë | Çmimi Fillestar/copë | Çmimi nga ofertuesi | Çmimi total € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Smart Micro Compact, viti i prodhimit 2002 benzin ngjyre e hirit metalike, me targa vendore | 1 copë | 1,800.00€ | | |
| 2 | Opel Corsa, viti i prodhimit 2008 dizel ngjyre e kaltër e hapur, me targa vendore | 1 copë | 4,000.00€ | | |
| 3 | Skoda Fabia, viti i prodhimit 2000 benzin ngjyre e kaltër, me targa vendore | 1 copë | 1,200.00€ | | |
| 4 | Opel Vectra 1.6 16V, viti i prodhimit 1999 benzin ngjyre e kaltër, me targa vendore | 1 copë | 800.00€ | | |
| 5 | Mercedes Benz 250D, viti i prodhimit 1991 dizel, ngjyre e gjelbër, me targa vendore | 1 copë | 400.00€ | | |
| 6 | Audi A4 Karavan, viti i prodhimit 2004 benzin ngjyre e hirit, për pjese | 1 copë për pjese | 800.00€ | | |
| 7 | Opel Vectra karavan, ngjyre e hirit, për pjese | 1 copë për pjese | 300.00€ | | |

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 14.02.2020 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 11.02.2020, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.
Pasurit e konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se,në: https://md.rks-gov.net/ Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.
Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KRIT", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810056938 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KRIT" D.O.O., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810056938 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KRIT" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810056938 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Dr Shpresa Ramadani nr. Lnj. 1004987485, shpall te pavlefshme provimin e licencës te lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë date 16 tetor 1999 nr, PP-D-27/99.

Arijon Ibrahimi B.I. N.P.SH. “Active-Konto” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70600226 nr. Fis. 600210827 dhe nr unik. 810715055.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009

▶ Kapllan Sinani shpall të pavlefshme dëftesat e SHF "Millun Jakshiq" (kl.I-VIII) Runik.

▶ Kastriot Sadiku shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomin "Isa Boletini" Mitrovicë.

▶ Petrit Selimi shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L




MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues